



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA:

DËNIMI ME GJOBË SI DËNIM KRYESOR NË TERRITORIN E GJYKATËS THEMELORE TË TETOVËS NGA VITI 2007-2012

KANDIDATI:
Nusret Asani

MENTORI:
Prof.dr. Ismail Zejneli

Tetovë, 2018

Përmbajtja

- **Lënda e hulumtimit**
- **Qëllimi i hulumtimit**
- **Metodologjia e hulumtimit**

Pjesa hyrëse

KAPITULLI I PARË

I.Sistemi i dënimeve sipas KPM.....	9
1.1 . Historiku.....	10
1.2. Kuptimi i dënimit me gjobë në KPM.....	12
1.3. Qëllimi i dënimit me gjobë.....	13
1.4. Zbatueshmëria e dënimit me gjobë në disa kode penale të rajonit.....	14

KAPITULLI I DYTË

<i>I. Matja e dënimit me gjobë – Vështrime hyrëse.....</i>	17
1. 1. Matja ligjore e dënimit me gjobë në KPM.....	17
1.2. Matja gjyqësore e dënimit me gjobë në KPM.....	18
1.3. Shqiptimi dhe ekzekutimi i dënimit me gjobë.....	20
1.4. Përcaktimi i vlerës së gjobës ditore.....	23

KAPITULLI I TRETË

<i>I. Dënimi me gjobë si dënim kryesor ndaj personave fizik dhe juridik.....</i>	25
1.1. Dënimi me gjobë si dënim kryesor ndaj personave fizik.....,	25
1.2. Dënimi me gjobë si dënim kryesor ndaj personave juridik.....	26
1.3. Ekzekutimi ose zëvendësimi i dënimit me gjobë me burgim	30

KAPITULLI I KATËRT

<i>I. Aspekte kriminologjike të dënimit me gjobë.....</i>	32
1.1. Fenomenologjia e shqiptimit të dënimit me gjobë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga viti 2007 – 2012.....	32
1.1.1. Veprat penale kundër sigurisë në komunikacion.....	33
1.1.2. Veprat penale kundër pasurisë.....	35
1.2. Etiologjia e kryerjes së veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë.....	39
1.2.1. Faktorët objektiv.....	39
1.2.2. Faktorët subjektiv.....	42
1.3. Ekzekutimi i dënimit me gjobë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga viti 2007 – 2012.....	44

KAPITULLI I PESTË

<i>I. Parandalimi dhe luftimi i veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë.....</i>	48
1.1. Masat preventive.....	48
1.1.1 Arsimimi dhe edukimi	49
1.1.2.Roli i mediave të shkruara dhe elektronike	50
1.1.3 Organizatat joqeveritare.....	51
1.1.4 Roli i familjes.....	52
1. 2. Masat represive.....	52
1. 2.1 Policia.....	53
1.2.2 Prokuroria.....	54
1.2.3 Gjykatat.....	55
1.2.4 Institucionet pentitenciare.....	56
Përfundimi.....	59
Literatura.....	61
Table of contents.....	65

Lënda e hulumtimit

Dënimi me gjobë është një ndër dënimet më të shpeshta që shqiptohet nga ana e Gjykatës Themelore të Tetovës. Ky dënim është rregulluar me Kodin penal të Republikës së Maqedonisë kryesisht në nenin 38, ku bën përcaktimin e gjobave ditore duke filluar nga numri më i vogël i gjobave që nuk guxon të jetë më i vogël se pesë e as më i madh se 360 gjoba ditore.

Nga vetë fakti që ky dënim dita ditës sa vjen dhe shpeshtohet, më ka bërë që ti qasem kësaj fushe studimi, me qëllim që të vë në pah të gjitha pyetjet që mund të lindin rreth shqiptimit si dhe ekezekutimit të dënimit me gjobë ne Gjykatën Themelore të Tetovës.

Ky punim hulumtues shkencorë në brendi do të permbajë: hyrjen, përmbajtjen si dhe gjithësej pesë kapituj, përfundimin dhe bibliografinë.

Në kapitullin e parë e pashë të arsyeshme që fillimisht të njihemi me dënimet që janë të përcaktuara nga KPM, pastaj të shohim historikun e zhvillimit të dënimit me gjobë. Poashtu këtu do të flitet për nocionin juridik të dënimit me gjobë, qëllimin e këtij dënimi si dhe zbatueshmërinë e dënimit me gjobë në disa kode penale të rajonit.

Kapitulli i dytë është bazamenti i këtij punimi shkencorë, ngase këtu do të flitet për matjen e dënimit me gjobë, dhe atë matjen ligjore si dhe matjen gjyqësore. Poashtu këtu do të flitet për shqiptimin e këtij dënimi, dhe si vjen deri te ekzekutimi i të njejtit.

Në kapitullin e tretë do të flitet për dënimin me gjobë si dënim kryesor ndaj personave fizik gjithashtu edhe për personat juridik, pastaj do të flitet edhe për ekzekutimin e dënimit me gjobë dhe zëvendësimin e këtij dënimi me burgim.

Në kapitullin e katërt do të flitet për aspektet kriminologjike të dënimit me gjobë, për fenomenologjinë e shqiptimit të dënimit me gjobë, për etiologjinë e kryerjes së veprave penale kur shqiptohet dënim me gjobë si dhe për ekzekutimin e dënimit me gjobë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga viti 2007-2012.

Ndërsa në kapitullin e pestë do të flitet për parandalimin dhe luftimin e veprave penale kur shqiptohet dënim me gjobë, do të flitet për masat të cilat ndërmeren për parandalimin dhe luftimin e veprave penale kur shqiptohet dënim me gjobë siç janë : masat preventive dhe masat represive.

Qëllimi i hulumtimit

Numri i gjobave që shqiptohen çdo ditë e më tepër vjen duke u rritur, kjo është edhe arsyeja që më ka bërë ti qasem studimit të këtij dënimi. Ndër qëllimet kryesore të këtij punimi të magistraturës është që të vë në dukje te gjitha anët pozitive dhe negative të dënimit me gjobë nga njëra anë ndërsa nga ana tjetër dëshiroj që të informoj qytetarët e Tetovës për atë se sa vjen e shpeshtohet dënimi me gjobë, duke iu ofruar të dhëna statistikore nga Sektori për punë të brendshme nga Gjykata Themelore e Tetovës si dhe nga Enti Shtetërorë për statistikë.

Gjithashtu dua të vë në dukje faktorët që ndikojnë në sjelljet kriminale për të cilat shqiptohet dënimi me gjobë, poashtu edhe rolin parandalues të shumë institucioneve. Ky punim le të jetë porosi përcjellëse për respektimin e ligjeve pozitive të vendit me qëllim që të kemi një zvogëlim të shqiptimit të këtij dënimi.

Metodologjia e hulumtimit

Teknikat dhe metodat që do të përdoren gjatë hulumtimit të këtij punimi shkencorë paraqesin procedurë të veçantë për mbledhjen e të dhënave lidhur me fushën e cila shkencërisht gjurmohet, e që në këtë rast është dënimi me gjobë. Sëpari për te filluar një punë shkencore është e domosdoshme të përcaktohet mënyra e hulumtimit, pra, si do të mund të arrijmë deri tek informatat që do të na duhen për punën shkencore. Dhe këtë mund ta arrijmë duke i përcaktuar metodat e hulumtimit nga të përgjithshmet deri te ato të posaçmet. Përvëç metodave të përgjithshme që shërbejnë për hulumtim në përgjithësi, gjatë këtij punimi gjithashtu do të hyjnë në punë edhe disa metoda të posaçme që do të më ndihmojnë shumë për çështjen e dënimit me gjobë, konkretisht. Ato janë: metoda e rasteve individuale, metoda statistikore, metoda e anketës dhe intervistës. Duke vënë në përdorim këto metoda hulumtimi do të jetë më i lehtë, ndërsa punimi do të del më i suksesshëm. Këto metoda gërshetohen ndërmjet veti duke u plotësuar njëra me tjetrën. Pasi nëpërmjet të dhënave të fituara nga njëra realizohet qëllimi i pritur i metodës tjetër. Secila nga metodat e lartëpërmendura e ka qëllimin e vet. Vlen të përmendim shkaqet e përdorimit të secilës prej këtyre metodave dhe teknikave hulumtuese. Me anë të intervistës dhe anketës, do të sigurojmë të dhëna që do të na nevojiten për të parë mendimin publik, gjithashtu të sigurojmë informacione që do të na shërbejnë për statistikën e shqiptimit të dënimit me gjobë nga viti në vit, thjeshtë me anë të këtyre metodave do të bëjmë mbledhjen e të dhënave në fushën e krimit, për të cilat shqiptohet dënim me gjobë. Metodë tjetër kemi studimin e rasteve individuale, metodë kjo që është pak sa e vështirë të realizohet, mirëpo do të mundohem që të njejten ta vë në përdorim. Gjatë këtij punimi hulumtues shkencorë gjithashtu do të shërbehem me metodën krahasuese si një ndër metodat mjaft të rëndësishme në aspektin e hulumtimit të shqiptimit të dënimit me gjobë në Gjykatën Themelore të Tetovës, poashtu edhe më gjërë. Me anë të kësaj metode do të bëjmë krahasimin e shqiptimit të këtij dënimi nëpër periudha të ndryshme kohore 2007-2012. Duke i vënë në funksion këto metoda shumë më lehtë do të mund të arrijmë qëllimin e pritur të këtij punimi hulumtues shkencorë.

Hyrje

Dënimi me gjobë, si dënim pasuror dhe si dënim më i vjetër se të gjitha dënimet tjera, është dënimi i cili bashkë me dënimin me burg shqiptohet më së shumti në Gjykatën Themelore të Tetovës. Duke e ditur se ky lloj dënimi shqiptohet më së shumti për veprat penale të rrezikshmërisë më të ulët, pra për veprat penale për të cilat më së shumti parashihet dënim me burg deri në tre vjet, në këtë punim jam fokusuar te veprat penale kundër sigurisë në komunikacion dhe veprave penale kundër pasurisë.

Si qëllim i këtij punimi është që të vë në dukje anët pozitive dhe negative të këtij dënimi, që të infirmoj qytetarët për numrin dhe lartësinë e këtij dënimi, për shqiptimin dhe ekzekutimin e këtij dënimi nga ana e gjykatës, për mënyrën e matjes së këtij dënimi, për format dhe mënyrat se si kryhet ky dënim, për shkaqet që paraqiten kur kryhen vepra penale për të cilat parashihet dënim me gjobë dhe për masat që ndërmarrin institucionet shtetërore për parandalimin e veprave penale kur shqiptohet dënim me gjobë. Punimi trajton çështje që janë në interes shoqërorë dhe shkencorë.

Punimi përbëhet nga hyrja, përmbajtja, përfundimi, bibliografia dhe pesë kapituj të të cilët sqarohet dënimi me gjobë duke dhënë definicione nga kode dhe ligje të ndryshme, duke bërë krahasime me sisteme të ndryshme, duke paraqitur faktorët të cilët ndikojnë për kryerjen e veprave për të cilat parashihet ky lloj dënimi.

Dënimi me gjobë është dënim që shqiptohet kudo në botë dhe për çdo shtet ekzistojnë statistika të ndryshme. Ndërsa për territorin e Gjykatës Themelore kam hulumtuar në regjistrat penal të Gjykatës Themelore të Tetovës që këtë punim ta bëj më të plotë, gjithashtu kam nxjerrë edhe raste nga gjykata për të spjeguar në mënyrë të detajuar si duket një vendim gjyqësor.

Në këtë punim kam spjeguar edhe dënimin me gjobë për personat fizik edhe për personat juridik, për matjen e dënimit ndaj tyre, për shqiptimin dhe ekzekutimin dhe për lirimin e tyre nga dënimi.

Ky dënim është dënim që është shqiptuar gjithmonë dhe do të shqiptohet edhe në të ardhmen. Edhe pse është si dënim për vepra penale me rrezikshmëri më të vogël, shpresoj që ky numër nga viti në vit në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës të jetë sa më i vogël, duke shpresuar se institucionet shtetërore, shoqëritë civile të meren më shumë me programe dhe me aktivitete të ndryshme për të reduktuar sadopak numrin e kryerësve të veprave penale për të cilat parashihet ky dënim, posaçërisht për personat e moshës së re të cilët mashtrohen më lehtë për të kryer vepra penale.

KAPITULLI I PARË

1. Sistemi i dënimeve sipas KPM-së

Me sistem të dënimeve nënkuptohet përmbledhja e të gjitha dënimeve që ekzistojnë në legjislacionin e dënimeve të një shteti, raportin e tyre të ndërsjelltë dhe rregullat për matjen e tyre gjyqësore. Sistemi i dënimeve dhe struktura e saj janë karakteristikë për çdo shtet. Sot është e vështirë të gjinden shtete të cilat kanë sistem të njëjtë absolut të dënimeve. Kjo është për shkak të shumë rrethanave, që do të thotë dallime mund të ekzistojnë në qëllimet e dënimit, në shkallën e kriminalitetit, në manifestimin e tij, në dallueshmerinë e shkallës së zhvillimit ekonomik, në shkallën e zhvillimit të civilizimit e të ngjashme. Sistemi i dënimeve mund të jetë i vendosur në numër të ndryshëm të dënimeve, më shumë ose më pak. Ekzistimi i më shumë dënimeve mundëson realizimin më të suksesshëm të parimit të individualizimit.¹ Para ndryshimeve në KPM të vitit 2004, legjislacioni ynë penal njihnte vetëm dy lloje dënimesh; dënimin me burg dhe dënimin me të holla. Me këto ndryshime, repertoari i dënimeve është zgjeruar edhe me tre lloje dënimesh që më parë ishin paraparë si masa të sigurisë. Ndërsa pas ndryshimeve të vitit 2004, sipas KPM-së për vepra penale, kryerësve përgjegjës të veprave mund t'u shqiptohen pesë lloje dënimesh: burg; dënim me të holla; ndalim i ushtrimit të profesionit; ndalim i drejtimit të automjetit dhe dëbim i të huajit nga vendi.² Dënimet ndahen në dy grupe: kryesore dhe sekondare. **Dënimet kryesore janë:** burgu dhe dënimi me të holla. Dënimi me burg mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesor. Dënimi me të holla mund të shqiptohet si dënim kryesor edhe si sekondar së bashku me dënimin me burg ose dënimin me kusht me të cilin është paraparë dënimi me burg. Për raportin mes dënimit me burg dhe dënimit me të holla me rëndësi janë edhe këto kushte ligjore: së pari nëse për veprën penale janë paraparë në mënyrë alternative të dy dënimet si kryesore, mund të jetë njëra veç kur me ligj është e paraparë se mund të shqiptohen të dyja. Po ashtu për vepra penale të kryera shfrytëzim dënimi me të holla, si dënim sekondar mund të shqiptohet edhe kur nuk është paraparë me ligj ose kur me ligj është përcaktuar në mënyrë alternative me dënimin me burg dhe gjyqi si kryesor do ta shqiptojë dënimin me burg. Për përcaktimin e këtyre dënimeve është vërtetuar edhe një rregull: kur për veprat penale është përcaktuar dënim me burg pa emërtimin e masës më të vogël, kurse masë më e madhe nuk është më e madhe se tre vjet përkrah kësaj të cilës detyrimisht është përcaktuar edhe dënimi me të holla (n.35 p.6). Me statumin e obligimeve (që ligjvënasi ia vendos vetes) për përcaktime alternative ose komulative të dënimit me të holla, në raste të tilla në fakt është shprehur dispozita kriminale – politike e ligjvënësit për tërheqjen e vijës kufizuese në mes formave të mesme dhe të rënda të krimit: është përcaktuar dënimi me burg deri në tre vjet pa përcaktuar minimumin ligjor të posaçëm, i cili vendosë dhe kufizon hapsirën ku së bashku me dënimin me burg konkurrojnë për zbatim jo vetëm dënimi me të holla por masat tjera alternative!³ Domethënë në grupin e parë ku bëjnë pjesë dënimi me burg dhe dënimi me gjobë janë dënimet që shqiptohen si dënimet

¹ Сламков, Ѓорѓи; КАЗНЕНО ПРАВО-ОПШТ ДЕЛ, Скопје, 2009, стр.266

² Kambovski, Vllado; E DREJTA PENALE- PJESA E PËRGJITSHME (përkthim), Shkup, 2006, fq.478

³ Po aty, fq.478

kryesore, pra, dënimi me burgim mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesor ndërsa dënimi me gjobë mund të shqiptohet si dënim kryesor së bashku me dënimin me burg ose dënimin me kusht me të cilin është paraparë dënimi me burg. Dënimet sekondare janë: ndalimi i ushtrimit të profesionit, detyrës ose veprimtarisë, ndalimi i drejtimit të automjeteve, dëbimi i të huajit nga vendi. Këto dënime shqiptohen kur kryerësit si dënim kryesor i është shqiptuar dënimi me burg ose dënimi me të holla në kushtet e përcaktuara me dispozitat ligjore. Me ligj mund të përcaktohet edhe shqiptim i detyrueshëm i dënimeve sekondare (n.33-5). Nga kjo rregull është paraparë ky përjashtim: dënimi ndalesa e drejtimit të automjetit që mund të shqiptohet si i vetëm (dhe kryesor) dënim i kryerësit të veprës së kryer nga pakujdesia për të cilën është përcaktuar dënim me të holla ose dënim me burg deri në një vit nëse vepra është kryer në rrethana lehtësuese. Në këtë rast, ky dënim paraqitet si substitut i dënimin të përcaktuar kryesor. Të gjitha dënimet sekondare mund të shqiptohen së bashku me dënimin me burg. Dënimi ndalesë e kryerjes së profesionit, veprimtarisë e detyrave mund të shqiptohet së bashku me gjykimin me kusht me të cilin është paraparë dënimi me burg (n.33-6 kodi penal). Dënimet ndalesa për drejtimin e automjeteve dhe dëbimi i te huajit nga vendi mund të shqiptohet edhe kur kryerësit i është shqiptuar dënimi me të holla, dënimi me kusht, ose vërejtje gjyqësore.

Sistemi i dënimeve sekondare në RM është relativisht i vogël në krahasim me legjislaturat tjera në të cilat dënimet e tilla janë përshkruar pasoja të ndryshme juridike të veprës penale. Pjesë nga ata nxjerrin nga dënimet jo të ndershme të reduktimit të statusit social, gjegjësisht humbjen e autoritetit të të gjykuarit (që nga koha e së drejtës romake infamija si pasojë e gjykimit për krimin, do të thoshte humbje e së drejtës së votës, kryerjen e funksioneve publike, dëshmitar para gjyqit.⁴ Pra, sistemi i dënimeve në Republikën e Maqedonisë para vitit 2004 njihje vetëm dy lloje dënimesh, dënimin me burg dhe dënimin me gjobë, ndërsa pas ndryshimeve të viti 2004 sistemi jonë i dënimeve pasurohet edhe me disa lloje të dënimeve, që më parë kanë qenë të parapara si masa të sigurisë ndërsa sot llogariten si dënime sekondare siç janë: ; ndalimi i ushtrimit të profesionit, ndalim i drejtimit të automjetit, dhe dëbimi i të huajit nga vendi. Me gjithë ndryshimet përsëri si dënime që shqiptohen më së shumti janë burgu dhe dënimi me gjobë.

1.1.Historiku i dënimit me gjobë

Në zhvillimin historik të dënimit, dënimi me gjobë është më i vjetër se dënimi- të privuarit nga liria. Në periudhën e parë të hakmarrjes private, kompensimi dhe plotësimi i dëmit paraqisnin sanksionin themelor për më shumë vepra. Në Romën e vjetër dënimi në të holla ka qenë dënim i rregullt edhe për vepra më të rënda, kurse burgu ka shërbyer për mbajtjen e shkurtë të kriminelëve.⁵

⁴ Kambovski, Vllado; E DREJTA PENALE- PJESA E PËRGJITSHME (përkthim), Shkup, 2006, fq.479

⁵ Po aty, fq.484

Dënimi me gjobë ose me të holla, gjithashtu rrjedh nga kompozicioni i kohës së reagimit privat. Dënimi me gjobë ose me të holla është ndër dënimet më të hershme. Esenca e tij qëndron në pagimin e një shume të hollash që e cakton organi kompetent i shtetit, si p.sh. gjykata apo ndonjë organ tjetër. Dënimi me gjobë në të kaluarën arkëtohej në llogari të arkës së shtetit, e më vonë në arkë të perandorit apo sunduesit ose feudalëve lokalë, përkatësisht pushteti lokal. Më vonë, dënimi me të holla ka mundur të arkëtohet edhe në interes të paditësit. Dënimet me të holla ose me gjobë zakonisht aplikoheshin ndaj tregtarëve edhe ndaj kryerësve të veprave kunder pronës dhe për delikte të lehta.⁶ Siç shihet, dënimi me të holla në periudhën e kaluar ka qenë njëri ndër dënimet më dominante të kohës, ku në disa sisteme shtetërore të kohës ka qenë si dënim i dyfishtë, me të cilin njëri dënim ka qenë i paraparë për të dëmtuarin, pra si kompensim për të dëmtuarin, ndërsa tjetri është paguar në dobi të shtetit, ndërsa ky rregull ndryshoi në shekullin e XIV ku i dëmtuari nuk fitonte më asgjë, dhe humbi interesimin e ndjekjes së kryerësit. Mëpastaj dënimi me të holla ka qenë i paraparë edhe për veprat penale të vrasjes gjatë mesjetës, që është llogaritur si dënim më human për dallim nga koha që ka pasuar ku janë paraqitur dënimet trupore dhe dënimi me vdekje. Në shekullin VI të popujt gjermanë u paraqitën dy lloje dënimesh në të holla: njëra shkonte në dobi të të dëmtuarit, kurse tjetra shkonte në dobi të shtetit. Sistemi i tillë u mbajt edhe në periudhën e hershme të mesjetës (X-XIII) ku dënimi në të holla ka qenë dominant edhe për vepra të vrasjes, që i jepte sistemit të dënimin formën më humane në krahasim me periudhën e mëvonshme të zbatimit të dënimin me vdekje dhe dënimin trupor! Dënimi i sotëm me të holla si dënim juridik-publik e ka origjinën nga ky dënim ose pjesë e dënimin me të holla që e kanë paguar në dobi të shtetit. Për shkak të menjanimin të dobësisë themelore të dënimin me gjobë – në mënyrë jo të drejtë t'i godet kryerësit e veprave penale në varshmëri nga gjendja pasurore e tyre, në legjislaturat evropiane është lënë sistemi i përcaktimit fiks i dënimin me të holla dhe me të madhe është pranuar modeli skandinav i dënimin me të holla i njohur si sistemi i gjobës ditore. Ideja e zbatimit të sistemit të tillë u paraqit në fillim të shekullit të kaluar në Suedi (propozim KP suedez i vitit 1916 I prof. Thyren), kurse për herë të parë u inagurua në Finlandë më vitin 1921, në Suedi më vitin 1931, në Danimarkë më vitin 1939 (sot në keto shtete mbi 75% e dënimeve të shqiptuara janë me të holla). Sistemi i gjobave ditore përbëhet në përcaktimin e numrit të gjobave ditore sipas shkallës së padrejtësisë dhe fajit të autorit, ku madhësia e gjobës ditore përcaktohet sipas rrethanave personale dhe pasurore të kryerësit. Ligji përcakton numrin më të madh dhe më të vogël të gjobave në dite (p.sh. 5-35 ditë) si dhe gjobën ditore (p.sh. prej 1-1000 euro). Konkretisht, sasia e gjobës ditore përcaktohet sipas rrethanave personale dhe pasurore të kryerësit. Ky sistem është pranuar në shumë legjislatura evropiane: me reformën e KP gjerman të vitit 1975, LP francez I vitit 1992, në SHBA ky sistem zbatohet prej vitit 1988, së pari në formë të pilot planit në shtetin e Nju Jork, në Angli është zbatuar me Criminal Justice act nga viti 1991 (mbi 85% e dënimeve të shqiptuara janë në të holla.⁷ Domethënë, sistemi i gjobës ditore është sistem i kohës moderne, i cili është i paraparë sipas rrethanave personale dhe pasurore të kryerësit, pra duke marrë parasysh këto rrethana gjyqi cakton edhe shumën e

⁶ Halili, Ragip; PENOLOGJIA, Prishtinë, 2005, fq.91

⁷ Kambovski, Vllado; E DREJTA PENALE- PJESA E PËRGJITHSHE (përkthim), Shkup, 2006, fq.486

gjobave ditore që kryerësi duhet ti paguaj shtetin për veprën e kryer. Nga kjo që u shtrua më lartë mund të konstatojmë se, dënimi me gjobë është një ndër dënimet më të hershme, që do të thotë se është dënim që ka ekzistuar shumë më përpara se dënimi me burg apo dënimi me heqje të lirisë. Ky lloj dënimi i cili konsiston në pagimin e një shume të caktuar në llogari të shtetit. Varësisht prej sistemeve në të kaluarën dënimi me gjobë është ekzekutuar në forma të ndryshme, mënyra të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme, varësisht prej sistemit shtetërorë të kohës. Ndërsa sistemi i gjobës ditore, siç u përmend fillet e saja i ka në Suedi, ndërsa për herë të parë ka filluar të zbatohet në Finlandë, gjatë shekullit të kaluar. Sipas autorit të njohur gjerman, Politz, dënimi me gjobë ka ndikuar dukshëm në kufizimin e armiqsive dhe konflikteve e njëherit edhe në kufizimin e aplikimit të dënimeve trupore dhe fizike. Nëse nuk është bërë ekzekutimi i dënimit në të holla, atëherë ky dënim zëvendësohet me dënime më të ashpra, si dënimet trupore, dënimi me punë të rënda fizike, shndërrimi në skllavë apo në robë etj. Nga dënimet me gjobë më vonë lindin edhe idetë dhe mendimet për humanizmin e dënimeve barbare dhe zëvendësimin e tyre me dënime të tjera të cilat kontribuojnë në riedukimin dhe riintegrimin e personave të dënuar.⁸

1.2.Kuptimi i dënimit me gjobë

Dënimi me gjobë është dënim i cili e godet pasurinë e kryerësit të veprës penale. Për kuptimin e dënimit me gjobë gjatë historisë janë dhënë shumë definicione pak a shumë të ngjashme, nëpër ligje dhe kode të ndryshme penale, në literatura të ndryshme dhe me autorë të ndryshëm. Duke filluar nga e drejta jonë penale do të përmendi disa kode dhe ligje që japin definicionin e dënimit me gjobë. Dënimi me gjobë është dënim në pasuri që përbëhet në imponimin e të dënuarit obligim penal – juridik për të paguar shumë të hollash shtetit për veprën e kryer penale. Si dënim publik – juridik ai nënkupton pagimin e shumës së të hollave shtetit dhe jo obligim civil i kryerësit kundrejt shtetit. Për këtë ai nuk mund të kompensohet, bartet ose merret nga tjetri ose të trashëgohet.⁹ “Gjoha në gojë të Kanunit, është një sasi pasurie, një sasi vlerash material a një shumë e caktuar parash për faje të ndryshme që fshati a flamuri ja merr fajtorit pas dëmit që do t’ia paguaj të dëmtuarit. Gjoha ishte ndëshkim penal pasuror që e shqiptonte gjyqi i pleqve të vëllazërisë – fisit, fshatit o flamurit, e i cili konsistonte në detyrimin e fajtorit për të paguar një sasi vlerash materiale apo shumë të caktuar parash për faje të ndryshme, pos dëmit që do t’ia paguante të dëmtuarit. Gjoha si ndëshkim kryesor – i pavarur shqiptohej për shumë vepra penale që kryerësit i kryenin kur : shkrepnin pushkë në gra, në shtëpi e gja të gjallë, kur shtytnin tjetrin me vra personin e caktuar, kur i vjedhnin shtazën e huaj dhe e fshehnin në kishë pa dijen e famulltarit, kur merrnin me dhunë armën, fyenin famulltarin apo hoxhën faqe popullit, kur kërcënonin famulltarin apo hoxhën, kur vrisnin qenin në stellë, kur vidhnin zgjuan e bletës, kur

⁸ Halili, Ragip; PENOLOGJIA, Prishtinë, 2005, fq.92

⁹ Kambovski, Vllado; E DREJTA PENALE- PJESA E PËRGJITSHME (përkthim), Shkup, 2006, fq.484

merrnin shtazë në vathë e raste tjera.¹⁰ Pra, edhe këtu bëhet fjalë për dënimin me gjobë që është shqiptuar për vepra penale më të lehta. Si dënim pasuror dënimi me gjobë ka edhe aspektet pozitive edhe aspektet negative. Sipas profesorit Gjorgji Sllamkov, si të gjitha dënimet edhe dënimi me gjobë ka karakteristika të caktuara nga aspekti pozitiv dhe aspekti negativ. Si aspekt pozitiv i përmendën: ikja nga burgimi i shkurtër, e bashkë me të edhe të gjitha pasojave negative të tij; është lehtë e riparushme në rast të gjykimit të pariparueshëm; është në interes të shtetit, sjell *përfitime* në vend të shpenzimeve. Ndërsa si aspekt negativ përmendën: duke filluar nga gjendja e ndryshme ekonomike e qytetarëve për disa dënimi me gjobë i caktuar do të jetë i lartë, ndërsa për disa të tjerë i papërfillshëm; pastaj, shumë rëndë ta quajmë individual për shkak se e godet të gjithë familjen; nuk ekzistojnë garanca absolute që dënimi me gjobë me të vërtetë do të paguhet nga kryerësi i veprës, atë mund ta kryej edhe ndonjë person tjetër, për shembull, shtytësi.. Karakteristika e fundit negative e dënit me gjobë është veçanërisht e dëmshme për shkak se dënimi me gjobë është rreptësisht individual, është i papranueshëm pagimi i saj nga ana e personit të tretë, në vend të të dënuarit, për shkak se me atë do ta humbte kuptimin e saj të së keqes drejtuar kundër kryerësit.¹¹

1.3. Qëllimi i dënit me gjobë

Qëllimi i dënit është pyetje e cila është diskutuar shumë në teorinë e të drejtës penale. Kur flasim për qëllimin e dënit mendohet në atë se çka duhet të arrihet me zbatimin e dënit kundrejt kryerësit të veprës penale.

Qëllim i përgjithshëm i sanksioneve penalo – juridike është mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe vlerat tjera themelore nga veprat penale. KPM e konkretizon duke përcaktuar edhe qëllimet e veçanta të sanksioneve të ndara. Me theksimin e qëllimeve të posaçme potencohet edhe natyra e veçantë e llojeve të ndryshme të sanksioneve.

Si qëllime të posaçme të dënit përveç realizimit të drejtësisë të ndarë janë: ndalimi i autorit të kryej vepra penale dhe riedukimi i tij, dhe ndikimi edukativ mbi tjerët për të mos kryer vepra penale(n.32). Me këtë, ligji i thekson në fakt funksionet polivalente të dënit: retributivitetin dhe preventivën gjenrale dhe preventivën speciale.¹² Që nga paraqitja e së drejtës penale e gjer më sot, çështja e qëllimit të dënit, sikundër edhe çështja e bazës juridike të dënit, është në qendër të vëmendjes së shkenctarëve. Kjo çështje është studiuar në aspektin juridik dhe filozofik. Rrjedhimisht, me rastin e parashikimit të dënit me ligj, është shtruar pyetja se çka dëshirohet të arrihet me zbatimin e dënit. Në shqyrtimin e kësaj çështjeje janë shfaqur mendime dhe teori të ndryshme filozofike dhe juridike. Të gjitha këto mendime dhe teori, duke i marrë parasysh tiparet e tyre të përbashkëta, mund të radhiten në tri grupe themelore:

¹⁰ Ukaj, Bajram; DËNIMET NË TË DREJTËN PENALE TË SHQIPËRISË, Prishtinë, 2006, fq.86

¹¹ Сламков, Ѓорѓи; КАЗНЕНО ПРАВО- ОПШТ ДЕЛ, Скопје, 2009, стр.274

¹² Kambovski, Vllado; E DREJTA PENALE- PJESA E PËRGJITHHME (përkthim), Shkup, 2007, fq. 460

1. Teoritë absolute, 2. Teoritë relative, 3. Teoritë e përziera apo ekletike

- 1. Teoritë absolute.** Sipas teorive absolute qëllimi i dënimit është hakmarrja ndaj personit që kryen veprë penale. Me kryerjen e veprës penale, individi i shkakton një të keqe shoqërisë, për këtë shkak shoqëria ia kthen këtë të keqe me zbatimin e dënimit.
- 2. Teoritë relative.** Përfaqësuesit e këtyre teorive janë të mendimit se dënimi duhet të ketë qëllim të caktuar social dhe se hakmarrja dhe shpaguesja e mëkateve për veprën penale të kryer, për të keqen e shkakuar, nuk duhet të jetë i vetmi qëllim i dënimit. Teoritë relative mund të ndahen në dy grupe kryesore, në teoritë e preventivës speciale dhe në teoritë e preventivës së përgjithshme ose gjenerale.
- 3. Teoritë e përziera.** Këto teori janë paraqitur duke i përvetësuar elementet pozitive të teorive absolute dhe të teorive relative. Pra, janë sintezë e teorive absolute dhe të teorive të preventivës individuale dhe gjenerale.¹³ Lidhur me teoritë e lartëpërmendura ku përmenden hakmarrja te teoria absolute si masë represive, dhe teoria realitve si masë preventive për të arritur qëllimin e dënimit mendoj se teoria e përzier është më e pranueshme për faktin se kjo teori bën të qartë se nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit vetëm duke u bazuar te njëra apo te tjetra, por duke i marrë parasysh të dy elementet mund të arrihet qëllimi i caktuar. Pra me dënimin me gjobë kërkohet që kryerësi i veprës të goditet në pasurinë e tij, pasi që njeriu e ndjen më shumë kur janë në pyetje të hollat. Qëllimi i dënimit me gjobë është që kryerësit të veprës penale t'i bëhet me dije në mënyrë serioze se ka kryer veprë të kundërligjshme dhe njëherit që për një kohë të caktuar ta godasë standardin e tij jetësor, goditje kjo e cila në mënyrën e tanishme të jetesës, në kushtet e shoqërisë konsumuese, ka rëndësi të madhe. Në këtë drejtim disa shtete si (p.sh. Austria, Gjermania, Suedia, Sllovenia, Kroacia) njohin sistem të tillë ndëshkimor, ku lartësia e dënimit me gjobë caktohet varësisht prej mëditjes, sa fiton për një ditë pune.¹⁴

1.4. Zbatueshmëria e dënimit me gjobë në disa kode penale të rajonit

Kjo pjesë ka të bëjë me zabtueshmerinë e dënimit me gjobë në disa kode penale të rajonit siç janë: Kodi penal i Republikës së Kosovës dhe Kodi penal i Republikës së Shqipërisë. Do të spjegoj secilën veç e veç për të parë ngjashmëritë dhe dallimet duke filluar nga Kodi penal i Republikës së Kosovës.

Do të fillojmë me Kodin penal të Republikës së Kosovës ku dënimin me gjobë e përcakton në nenin 46 ku thotë: Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) Euro Evropiane (në tekstin e mëtejme “EURO”). Dënimi me gjobë nuk mund të tejkalojë njëzet e pesëmijë (25.000) Euro ndërsa për veprat penale lidhur me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojë pesëqind mijë (500.000) Euro. Në aktgjykim caktohet afati i pagesës së dënimit me

¹³ Salihu, Ismet; E DREJTA PENALE- PJESA E PËRGJITHSHME, Prishtinë, 2003, fq, 441

¹⁴ Po aty, fq. 456

gjobë. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e as më i gjatë se tre (3) muaj, mirëpo në rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë që dënimi me gjobë të paguhet me këste për një periudhë që nuk tejkalon dy (2) vjet. Aktgjykimi po ashtu duhet të përcaktojë se kur duhet të paguhet këstet dhe duhet të cek se mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siç parashihet në paragrafin 3. të këtij neni. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e personit të dënuar, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë në dobi të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzet (20) Euro gjobë. Kohëzgjatja e punës në dobi të përgjithshme nuk mund të tejkalojë dyqind e katër dhjetë (240) orë. Dënimi me gjobë nuk ekzekutohet pas vdekjes së personit të dënuar. Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar.¹⁵

Ndërsa Kodi penal Republikës së Shqipërisë, dënimin me gjobë e përshkruan si vijon: Dënimi me gjobë konsiston në pagimin në favor të shtetit të një shume të hollash brenda kufijve të parashikuar në ligj. Dënimi me gjobë jepet për personat që kryejnë krim ose kundërvajtje penale. Për personat që kryejnë krim gjopa jepet nga 100 mijë gjer në 10 milionë lekë. Për personat që kryejnë kundërvajtje penale, gjopa jepet nga 50 mijë gjer në 3 milionë lekë. Për personat që kryejnë krime për motive të fitimit të pasurive ose të sigurimit të çdo lloj përfitimi tjetër material, nëse dispozita penale parashikon vetëm dënim me burgim, gjykata mund të japë edhe dënim me gjobë nga 100 mijë gjer në 5 milionë lekë. Gjkata jep dënimin me gjobë, pasi ka hetuar rreth aftësisë paguese të personit. Aftësia paguese përcaktohet nga gjendja personale dhe pasurore e personit, si dhe nga rrethana të tjera që lidhen me to. Dënimi me gjobë paguhet në afatin e caktuar në vendimin e gjykatës. Gjkata, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të të dënuarit, mund të lejojë që gjopa të paguhet me këste, duke caktuar këstet dhe afatin e pagimit të tyre. Kur i dënuari nuk e paguan gjobën dhe gjopa nuk mund të vilet nëpërmjet ekzekutimit të detyrueshëm, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim, duke llogaritur pesë mijë lekë për një ditë burgim. Kur i dënuari nuk mund të paguajë gjobën në afat pa fajin e tij dhe nëse kriteret, mbi të cilat është caktuar gjopa, kanë ndryshuar pas dhënies së vendimit dhe nuk e justifikojnë haptazi pagimin e gjobës, atëherë i dënuari mund të kërkojë:

a) shtyrje të afatit të pagesës së gjobës gjer në gjashtë muaj;

¹⁵ Neni 46 I Kodit Penal të Republikës së Kosovës

b) kryerjen e një pune me interes publik.

Nëse gjykata urdhëron kryerjen e një pune në interes publik zbatohen rregullat e nenit 63 të këtij Kodi. Nëse gjoba nuk paguhet edhe pas shtyrjes së afatit ose nëse i dënuari nuk e kryen punën në interes publik, gjykata vendos zëvendësimin e gjobës me burgim. Kur gjoba është dhënë për kryerjen e një krimi, zëvendësimi i saj me burgim nuk mund të kalojë tre vjet, ndërsa kur ajo është dhënë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale, zëvendësimi nuk mund të kalojë një vit burgim, por gjithmonë pa kaluar maksimumin e dënimit me burgim që parashikon dispozita përkatëse. Nëse dispozita penale nuk parashikon dënim me burgim, maksimumi i dënimit me burgim konsiderohet gjashtë muaj. Kur i dënuari si më sipër gjatë zbatimit të burgimit paguan gjobën, gjykata revokon vendimin, duke bërë llogaritjet sipas kriterit të paragrafit të 8 të këtij neni.¹⁶ Siç shihet në Republikën e Kosovës njëjtë si në sistemin tonë të dënimeve, dënimi me gjobë parashihet edhe si dënim kryesor edhe si dënim plotësues. Ndërsa në Republikën e Shqipërisë dënimin me gjobë si dënim kryesor jepet për kundërvajtje penale si dënim kryesor, ndërsa për krime, bashkë me dënimin me burg mund të shqiptohet edhe dënim me gjobë si dënim plotësues. Pra dallimi në mes sistemit tonë dhe sistemit të dy shteteve të lartëpërmendura nuk është edhe shumë i madh. Nuk ka shumë dallim edhe për ekzekutimin e dënimit me gjobë. Përderisa në Republikën e Maqedonisë ekziston afat i caktuar me ligj, brenda të cilit duhet të paguhet dënimin me gjobë, në Republikën e Shqipërisë gjyqi afatin e jep në bazë të gjendjes së të dënuarit dhe në bazë të gjendjes ekonomike të tij. Ndërsa në kodin penal të Republikës së Kosovës afati për pagesën e dënimit me gjobë jepet në aktgjykim. Në rast të mospagimit të dënimit me gjobë të gjitha kodet duke përfshirë edhe kodin tonë penal, parashohin mundësinë e pagesës së dënimit me këste ndërsa edhe nëse nuk paguhet edhe pas këtij afati, atëherë bëhet zëvendësimi dënimit me gjobë me burgim.

¹⁶ Neni 34 I Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë

KAPITULLI I DYTË

1. Matja e dënimit me gjobë – Vështrime hyrëse

Me matje të dënimit nënkuptojmë caktimin e llojit dhe të lartësisë së dënimit kryerësit të veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit duhet meodoemos të merren parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese që janë shprehur në momentin e kryerjes së veprës penale, në mënyrë që t'i caktohet ai lloj dhe masë e dënimit i cili do t'i pergjigjet peshës së veprës së kryer penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të kryerësit dhe me të cilën më së miri do të arrihej qëllimi.

¹⁷ Sipas nenit 39 të Kodit penal gjykata do t'i caktojë masën e ndëshkimit kryerësit të veprës penale në kufijtë e caktuara me ligj për atë vepër, duke pasur parasysh përgjegjesinë penale të kryerësit, peshën e veprës dhe qëllimet e ndëshkimit. Gjykata do t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë, dënimi të jetë më i madh apo më i vogël (rrethanat lehtësuese dhe vështirësuese), veçanërisht shkallën e përgjegjësisë penale, motivet pse është bërë vepra penale, fuqinë e rrezikimit apo shkatërimit të së mirës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është bërë vepra, kontributin e viktimës në kryerjen e veprës së bërë penale, si dhe rrethanat tjera që i përkasin personalitetit të kryerësit. Gjatë caktimit të masës së ndëshkimit gjykata posaçërisht do të ketë kujdes për veprimin e përgjithshëm të ndëshkimit dhe pasojat e tij ndaj personalitetit të kryerësit dhe nevojat e risocializimit të tij.¹⁸ Pra rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese janë kushte themelore gjatë matjes së dënimit.

Për matjen e dënimit ekziston:

1. Matja ligjore e dënimit me gjobë dhe
2. Matja gjyqësore e dënimit me gjobë

1.1. Matja ligjore e dënimit me gjobë

Në teorinë penalo-juridike ekzistojnë dy qasje kah përcaktimi nocionit të matjes së dënimit. Sipas të parit, ky nocion përfshinë edhe përcaktimet ligjore të dënimit edhe zgjidhjen dhe shqiptimin e dënimit nga ana e gjyqit. Sipas të dytit të shumicës, me matje të dënimit nënkuptohet vetëm aktiviteti i gjyqit në përcaktimin e dënimit për veprën konkrete. Në këtë lloj kuptimi të këtij nocioni çon edhe kuptimi etimologjik i tij: matja-gjithmonë drejton vlerësimin konkret dhe objektin konkret të vlerësimit të tillë. (Stoeclin, 23)

Megjithatë, edhe përkundër pranueshmërisë parimore të përcaktimit më të ngushtë të këtij nocioni, si matje gjyqësore e dënimit nuk mund të anashkalohej edhe përcaktimi ligjor apo matja e dënimit. Gjyqi në zgjidhjen e dënimit konkret nuk ka liri absolute, por është i lidhur për fjalën e ligjit për dënimin e përcaktuar sipas ligjit! Prej këtui, është e arsyeshme përveç matjes gjyqësore

¹⁷ Salihu, Ismet; E DREJTA PENALE- PJESA E PËRGJITHSHME, Prishtinë, 2003, fq, 500

¹⁸ Neni 39 paragrafi 1, 2 dhe 3 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë

të flitet edhe për matje ligjore të dënimit.¹⁹ Pra, gjyqi nuk e ka të drejtën ekskluzive që vetë të vendos për dënimet lidhur me veprat penale të shkaktuara, por duhet të bazohet në ligj, që mendoj se është përcaktim i duhur nga shkaku se përjashtohet mundësia që dikush të jetë i privilegjuar nga ana e gjykatësit. Me matje ligjore si dënim nënkuptohet përcaktim i dënimit nga ana e ligjvënësit për secilën vepër penale. Pastaj, ligjvënësi ka parasysh lloj të caktuar të veprës penale dhe lloj të kryerësit, dhe jo vepër konkrete ose kryerës konkret (Salleiles, 201). Ekzistojnë **dy sisteme** të matjes ligjore të dënimit: sistemi absolut i dënimeve të percaktuara dhe sistemi relativ i dënimeve të percaktuara. Në kornizën e përcaktuar ligjore gjyqi e mat dënimin në bazë të fajsisë për veprën e bërë nga rrethanat relative për matjen gjyqësore të dënimit. Me rëndësi është që kornizat penale të mos jenë të percaktuara as shumë gjërë as shumë ngushtë që të mund t'a shterin qëllimin gjeneralo – preventiv dhe speciało – preventiv të dënimit. Kornizat penale të gjëra e ndërprejnë linjën lidhëse të matjes gjyqësore dhe ligjore të dënimit me kërkesën për dënueshmëri të drejtë, ndërsa ata të ngushtat pamjaftueshëm i pëlqejnë elementet tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit dhe preventivën speciale duke i dhënë përparësi vetëm idesë së drejtshmërisë dhe retributivitetin. Nëpërmjet kornizave penale përcaktohet ose bie koncepti i përgjithshëm për dënimin dhe funksionet e tij polivalente! Pa funksionin e këtillë të matjes ligjore të dënimit do të vihej në pikëpyetje parimi i ligjshmërisë si parim themelor i së drejtës penale. Kërkesa për përcaktim ligjor të dënimit (nula poena sine lege) nuk kënaqet me atë që ligji të çdo vepër parasheh dënim të caktuar, por ai duhet të jetë i përcaktuar me precizimin e radiusit në të cilën do të lëvizte gjykatësi gjatë shqiptimit të tij! Në legjislacionet bashkëkohore korniza të gjëra penale janë vendosur në raport me dënimin me të holla: të disa vepra të ndara ai është i përshkruar në rregull pa përcaktim të masës më të madhe dhe më të vogël, ndërsa maksimumi dhe minimum i tij janë përcaktuar në dispozitat e përgjithshme për këtë lloj dënimi.²⁰

1.2. Matja gjyqësore e dënimit me gjobë

Me matje gjyqësore të dënimit nënkuptohet konkretizimi i dënimit i përcaktuar në mënyrë ligjore, gjegjësisht edhe shqiptimi i dënimit që i përgjigjet veprës së kryer dhe kryerësit të saj. Ky lloj definimi i këtij nocioni jep indicie për kompleksitetin e aktit të matjes së dënimit: kjo është njëkohësisht edhe akt juridik që përbëhet në zbatimin, shqiptimin e të drejtës (lus dicere), por edhe supozimin induktiv logjik që niset nga silogizma: dënimi i paraparë me ligj, vepra e kryer dhe personaliteti i kryerësit. Kështu, dënimi i paraparë me ligj është i dhënë jo fiks por në kornizat penale me mundësi të ndryshme me modelimin e tij, zbutjen ose edhe falja gjyqësore e dënimit.²¹ Domethënë gjatë matjes së dënimit gjykatësi bën matjen në atë mënyrë që dënimi të mund të përshtatet kryerësit pa mos dal nga përcaktimi ligjor, por që ka mundësi për të zbutur

¹⁹ Kambovski, Vllado; E DREJTA PENALE – PJESA E PËRGJITHSHME (përkthim) Shkup, 2007, fq. 499

²⁰ Po aty, fq. 500

²¹ Po aty, fq. 501

dënimin apo edhe për të falur. Këtë mund ta bëjë vetëm duke i'u permabajtur përcaktimit ligjor. Matja gjyqësore e dënimit me gjobë për personat fizik është e paraparë në nenin 38 të Kodit penal ku thuhet: gjykata bën matjen e numrit të gjobave ditore sipas rregullave të përgjithshme për matjen e dënimit. Lartësinë e gjobës ditore gjykata e cakton duke marrë parasysh mundësitë pasurore dhe personale të kryerësit, duke nisur nga rregulla e të ardhurave të pastra ditore që kryerësi i realizon ose mund t'i realizojë, si dhe nga obligimet tjera familjare të kryerësit dhe gjendjes së tij pasurore në kohën e sjelljes së aktgjykimit. Vlera më e vogël e gjobës ditore është një euro në kundërvlerë të denarit, kurse më e madhja 5000 euro në kundërvlerë të denarit. Vendimi gjyqësor përfshin shumën e dënimit me të holla që fitohet me shumëzimin e numrit të gjobave ditore me vlerën e caktuar të gjobave ditore.²² Pra siç shihet në paragrafet e lartëpërmendura të këtij neni gjykata gjatë matjes së dënimit me gjobë i kushton rëndësi të veçantë gjendjes pasurore të kryerësit si dhe familjes së kryerësit që nënkupton se dënimi me gjobë është dënim që e godet kryerësin në atë masë që mund të përballoj dënimin si dhe nuk ka për qëllim që me dënimin me gjobë të goditet familja e kryerësit financiarisht.

Përveç personave fizik, në nenin 96-dh paragrafi 1 dhe 2 të Kodit penal është e precizuar matja e dënimit me gjobë edhe për personat juridik ku thuhet: gjatë matjes së dënimit gjykatësi do të merr parasysh bilancin e gjendjeve dhe bilancin e suksesit të personit juridik, llojin e veprimtarisë dhe natyrën dhe peshën e veprës së kryer. Nëse gjykata përcakton dënim me gjobë për dy apo më shumë vepra në bashkim, dënimi i vetëm nuk mund ta arrijë përmbledhjen e dënimeve të caktuara individuale, e as ta tejkalojë maksimumin ligjor të dënimit të paraparë për personin juridik. Poashtu në nenin 96-e paragrafi 1, 2 dhe 3 të Kodit penal thuhet: për veprat për të cilat është paraparë dënim më gjobë ose dënim me burgim deri në tre vjet, personi juridik dënohet me dënim me gjobë prej 500.000 denarësh, apo nëse vepra është kryer nga levërdia ose është shkaktuar dëm në përmasa të mëdha më së shumti deri në shumën e dyfishtë nga dëmi i shkaktuar apo dobia e realizuar. Për veprat për të cilat është paraparë dënim më së paku 3 vjet burg, personi juridik, dënohet me dënim me gjobë deri në një million denarë, nëse vepra është kryer nga levërdia ose është shkaktuar dëm me përmasa të mëdha më së shumti deri në shumën e pesëfish të nga dëmi i shkaktuar apo dobia e realizuar. Për veprat penale për të cilat është paraparë dënim më së paku pesë vjet burgim, personi juridik dënohet me dënim me gjobë deri në një million denarë, apo nëse vepra është kryer nga levërdia ose është shkaktuar dëm me përmasa të mëdha më së shumti deri në Shumën e dhjetëfish të nga dëmi i shkaktuar apo dobia e realizuar.²³ Nga kjo që u spjegua më lartë mund të shohim se gjykata gjatë matjes së dënimit me gjobë bën matjen edhe për personat fizik edhe për personat juridik. Për personat fizik bën matjen duke u nisur nga mundësitë pasurore dhe personale të kryerësit, ndërsa për personat juridik duke marrë parasysh bilancin e gjendjes dhe bilancin e suksesit të personit juridik, llojin e veprimtarisë dhe natyrën dhe peshën e veprës së kryer.

²² Neni 38 paragrafi 2,3,4,5 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë

²³ Po aty, neni 96

1.3.Shqiptimi dhe ekzekutimi i dënimit me gjobë

Dënimi me gjobë është dënim i cili shqiptohet dhe ekzekutohet më së shpeshti pas dënimit me burgim në praktikën gjyqësore të shteteve të ndryshme në botën bashkëkohore. Dënimi me gjobë shqiptohet si dënim kryesor, si dënim alternativ dhe si dënim plotësues. Lidhur me ekzekutimin e tij në praktikën gjyqësore nuk ka probleme të veçanta kur personi i dënuar në mënyre vullnetare e zbaton këtë dënim gjegjësisht paguan gjobën me të cilën është dënuar nga gjykata kompetente. Mirëpo, problemet paraqiten kur personi i dënuar edhe pas akgjykimit të plotëfuqishëm dhe të ekzekutueshëm nuk e paguan këtë dënim në menyrë vullnetare. Në rastet e këtilla fillon procedura e ekzekutimit dhe arkëtimit me dhunë të dënimit më te holla. Personi i dënuar me këtë dënim zakonisht i bëhet me dije nga gjykata kompetente, e kjo gjykatë është përherë gjykata ku e ka vendbanimin ose vendqëndrimin personi i dënuar. Në vende të ndryshme këto gjykata emërtohen si gjykata përmbarese ose kanë emërtime të tjera.²⁴ Shqiptimi i dënimit me gjobë staton në obligimin për pagesë ekskluzivisht shtetit dhe jo të dëmtuarit, kërkesat e pasurisë sigurohen me kthimin e lëndëve ose me konfiskimin e shfrytëzimit të pasurisë ose dëmshpërblimin e dëmtimit. Dhe në fund, dënimi me të holla gjithmonë thirret në shumë të caktuar të hollash dhe nuk mund të përcaktohet në disa vlera të tjera që nuk paraqesin të holla, siç është pagesa në letra me vlerë, sende të shtrenjta ose terheqje të pasurisë!²⁵ Pra dënimi me gjobë nuk mund të paguhet me asgjë tjetër, përveç se me të holla. Procedura e shqiptimit të dënimit me të holla shqiptohet në dy faza : së pari gjyqi sipas peshës së veprës dhe shkallës së fajsisë të kryerësit, e përcakton numrin e gjobave ditore (p.sh. dhjetë euro). Sasia e dënimit me të holla fitohet me rritjen e numrit të përcaktuar të gjobave ditore me sasinë e gjobës ditore (në rastin konkret ai do të jetë 50 euro) Këtij sistemi i jepen vërejte se çon kah vendime të paralizueshme në raport me dënimin jo të njëjtë të kryerësit me potencialin pasurorë të ndryshueshëm, por i hedhet për diçka tjetër se e shkatërron tërësinë logjike të vendimit për dënimin dhe se për këtë përcaktimi i numrit të gjobave ditore është arbitrare, e nxjerrur nga impresionet që e ka gjyqtari në raport me peshën e dënimit që e meriton autori! Në zbatimin praktik të këtij sistemi, logjika e tillë e çon gjyqin së pari të vërtetojë një sasi të aplikueshme të paramenduar të dënimit e pastaj në menyrë plotësuese të konstruktojë numrin e gjobave ditore dhe çmimin e dënimit ditorë. Kundërshtimi për këtë veprim reverzibil të gjyqit mund të menjanohet nëse gjyqi e rregullon në mënyre precize përcaktimin e shumës së gjobës ditore, në mënyrë që të mundësojë kontroll të vendimit gjyqësor në procedurën me ankesë.²⁶ Esenciale është që gjykata duhet të vërtetojë shkallën e fajsisë dhe peshën e veprës dhe pastaj të përcaktojë sa gjoba ditore do të shqiptojë.

Ekzekutimi i dënimit me gjobë për personat fizik. Procedurën për arkëtimin e dënimit me gjobë të personave fizik sipas detyrës zyrtare e udhëheq gjykata e cila ka shqiptuar dënimin me gjobë në shkallë të parë. Nëse personi i dënuar nuk ka vendbanim, përkatësisht vendqëndrim në selinë

²⁴ Halili , Ragip; PENOLOGJIA, Prishtinë, 2006, fq, 251

²⁵ Kambovski, Vllado; E DREJTA PENALE – PJESA E PËRGJITHSHME (përkthim) Shkup, 2007, fq, 485

²⁶ Po aty, fq, 486

e gjykatës, e cila ka shqiptuar dënimin me gjobë në shkallë të parë, atëherë gjykata e shkallës së parë është e detyruar që t'ia dërgojë gjykatës aktgjykimin e plotëfuqishëm për arkëtimin e dënimit me gjobë sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin. Deri tek arkëtimi i gjobës mund të vjen për shkak të refuzimit të së njëjtës nga personat fizik apo juridik. Për arkëtimin e gjobës nga personat fizik zhvillohet procedurë e veçantë, të cilën sipas detyrës zyrtare e udhëheq gjykata e cila e ka shqiptuar dënimin me gjobë në shkallë të parë. Ekzistojnë raste kur personi i cili duhet të bëj pagimin e gjobës të mos posedon vendbanimin apo vendqëndrimin e vet. D.m.th. nëse personi i dënuar nuk ka vendbanim, përkatësisht vendqëndrim në selinë e gjykatës që ia ka shqiptuar dënimin me gjobë në shkallë të parë, atëherë gjykata e shkallës së parë është e detyruar që t'ia dërgojë aktgjykimin e plotëfuqishëm për arkëtimin e dënimit me para gjykatës sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin të personit të dënuar me gjobë. Për pagimin e dënimit me gjobë ekziston afati i caktuar, brenda të cilit duhet të bëhet pagesa. Nëse personi i dënuar nuk bën pagesën në afatin e caktuar me ligj, atëherë vjen deri tek ana tjetër e ekzekutimit të dënimit, d.m.th. ana detyruese, pra arkëtimi bëhet me detyrim. Por në rast se vjen deri tek arkëtimi i dënimit me gjobë përmes kësaj rruge, pra me detyrim, atëherë vijnë në shprehje shpenzime tjera shtesë që bëhen përderisa ekzekutohet ky dënim. Në raste të tilla shpenzimet e arkëtitimit të dënimit me gjobë, i cili ekzekutohet me anë të detyrimit bien në llogari të personit të dënuar, pra ato i mbulon vetë personi i dënuar, për arsye se ai ka qenë shkaktari që arkëtimi i dënimit me gjobë të ekzekutohet me detyrim.²⁷ Për së fundi herë, personit të dënuar i jepet edhe një herë mundësi me anë të vërejtjes që ai ta bëj pagesën e dënimit me para. D.m.th. detyrimi vjen si masë e fundit. Andaj, gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve para qasjes për arkëtimin e detyrueshëm, personit të dënuar i dërgon vërejtje që të paguaj dënimin me para në afat që nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë nga dita e pranimit të vërejtjes. Afati shtesë prej 15 ditësh i caktuar nga ana e gjykatësit për ekzekutimin e sanksioneve është afati i fundit, në të cilin personi i dënuar duhet të deklarohet se do ta paguaj apo jo dënimin me para. Nëse personi i dënuar në afatin e caktuar nuk e paguan dënimin me para, do të bëhet arkëtimi me detyrim. Megjithatë, ekzistojnë raste kur personi i dënuar i shkel të gjitha afatet e pagimit të dënimit me para, më pas zhvillohet procedura e detyrimit të arkëtitimit, por sërish nuk arrihet qëllimi, pra nga personi i dënuar nuk mund të bëhet arkëtimi për shkak të pamundësisë, skamjes, varfërisë etj. Në raste kur është zbatimi i detyrueshëm është i pasuksesshëm, atëherë bëhet zëvendësimi i dënimit me gjobë me burgim. Do të thotë se burgu si zëvendësim vjen si masë e fundit, pra kur nuk ka sukses pagesa në asnjë mënyre tjetër atëherë vjen në shprehje zëvendësimi i dënimit me gjobë me burgim.

Ligji për ekzekutimin e sanksioneve i jep mundësi personit të dënuar që në rast se nuk posedon mjete financiare të mjaftueshme që ta bëjë menjëherë pagimin e dënimit me para, ai atë ta bëjë edhe me këste, por në afat të caktuar. Pra, nëse personi dënuar, dënimin me para nuk mund ta paguaj menjëherë, atëherë mund ta paguaj me këste, por afati i pagesës nuk mund të jetë më i

²⁷ Osmani, Afrim; PENOLOGJIA, Shkup, 2017, fq.355

gjatë se 2 vjet, me mundësi për vazhdimin e afatit edhe për 3 muaj. Edhe me këtë mundësi që i jepet personit të dënuar, nëse ai sërish është i padëgjueshëm, atëherë veprohet më rreptë. D.m.th. nëse personi i dënuar nuk i paguan kështu me kohë, gjykata do ta revokojë vendimin e vet për pagesë me kështu dhe do të fillojë me arkëtimin e menjëhershëm të dënimit me para ose me zëvendësimin me burgim, i cili është i njohur si burgu supleator. Me vdekjen e personit të dënuar shuhet edhe dënimi me gjobë, kurse me të edhe privimi nga liria i cili nuk trashëgohet tek ndonjëri nga të afërmit e tij.²⁸ Mundësitë që jepen për pagesën e gjobës janë të shumta, mirëpo nga të gjitha këto mundësi përsëri efekti nuk është ai që duhet të jetë. Mendoj se afatet që jepen për pagimin e kështuve është zgjidhje e qëlluar nga shkaku se personat për atë afat që u jepet mund të sigurojnë të holla në mënyra të ndryshme.

Ekzekutimin e dënimit me gjobë për personat juridik. Dënimi me gjobë shqiptohet në shumë që nuk mund të jetë më e vogël se 100.000 denarë, e as më e madhe se 30 milion denarë. Për veprat penale të kryera nga levërdia, si dhe për veprat me të cilët realizohet apo shkaktohet dëm me përmasa të mëdha, mund të shqiptohet dënim me gjobë deri në shumën e dyfishtë të maksimumit të këtij dënimi apo në proporcion me lartësinë e dëmit të shkaktuar, gjegjësisht dobisë së realizuar, por më së shumti deri në shumën e dhjetëfishtë të tyre. Për veprat penale për të cilat është paraparë dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në tre vjet, personi juridik dënohet me dënim me gjobë prej 500.000 denarë apo nëse vepra është kryer nga levërdia ose është shkaktuar dëm me përmasa më të mëdha më së shumti deri në shumën e dyfishtë nga dëmi i shkaktuar apo dobia e realizuar. Për veprat për të cilat është paraparë dënim më se paku 3 vjet burgim, personi juridik dënohet me dënim me gjobë deri në një milion denarë, nëse vepra është kryer nga levërdia ose është shkaktuar dëm me përmasa të mëdha më së shumti deri në shumën e pesëfishtë nga dëmi i shkaktuar apo dobia e realizuar. Për veprat për të cilat është paraparë dënim më se paku pesë vjet burgim, personi juridik dënohet me dënim me gjobë deri në një milion denarë, apo nëse vepra është kryer nga levërdia ose është shkaktuar dëm me përmasa të mëdha më së shumti deri në shumën e dhjetëfishtë nga dëmi i shkaktuar apo dobia e realizuar.²⁹ Lidhur me procedurën për arkëtimin e dënimit me para të personave juridik, sipas detyrës zyrtare e ngre gjykata që e ka shqiptuar dënimin me para në shkallë të parë. Gjikata mund të fillojë me arkëtimin e dënimit me para vetëm atëherë kur aktgjykimi të hyjë në fuqi dhe pasi të skadojë afati vullnetar për pagim i cili është përcaktuar në vetë aktgjykimin. Së pari gjykata që ka shqiptuar dënimin me gjobë para se të bëjë ekzekutimin e detyrueshëm të dënimit, bën njoftimin dhe paralajmërimin e personit juridik se në afat prej 15 ditësh është i obliguar që të paguaj dënimin me para. Ky obligim duhet respektuar nga ana e personit juridik, se në rast të mosrespektimit, mund të vjen në ekzekutim të detyrueshëm.³⁰

Dënimi me gjobë që paguan personi juridik, apo paratë e arkëtuara shkojnë në buxhetin e Republikës së Maqedonisë. D.m.th. destinacioni i fundit i këtyre parave është arka shtetërore.

²⁸ Po aty, fq.355

²⁹ Po aty, fq.398

³⁰ Po aty, fq.399

Çdo person juridik është i obliguar që të bëjë edhe hapjen e llogarisë apo llogarive bankare në bankat vendore, apo edhe ato jashtë vendit. Kështu që, banka vendore është e obliguar që të njoftojë organet – gjykatën kompetente në afat prej 8 ditësh për zbatimin e dënimit me para. Por, ekzekutimi i dënimit me para mundet edhe të mos kryehet për shkak të asaj se qesja e personit juridik është e zbrazët. Në atë rast banka është e obliguar që të bëjë njoftimin e gjykatës kompetente që ka marr vendimin në shkallë të parë për situatën e krijuar.³¹ Nëse personi juridik nuk e paguan gjobën në afat të caktuar nga gjykata, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë, e as më i gjatë se 30 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ai do të ekzekutohet nga pasuria e personit juridik për shkak se personi juridik nuk ka pasuri të tillë apo ka pushuar së ekzistuari para ekzekutimit të dënimit, atëherë dënimi do të ekzekutohet nga trashëgimtari i tij juridik, e nëse nuk ka trashëgimtar juridik, atëherë nga pasuria e themeluesit apo themeluesve të personit juridik, proporcionalisht me pjesët e investuara, përkatësisht në rastet eaktuara me ligj të shoqatat tregtare nga pasuria e aksionarëve, përkatësisht e shoqëruesve, proporcionalisht të pjesëve të tyre. Dënimi me gjobë për personat e huaj juridik ekzekutohet nga pasuria e konfiskuar në Republikën e Maqedonisë ose me zbatimin e marreveshjes ndërkombëtare e ratifikuar duke qenë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.³² Si për personat fizik, poashtu edhe për personat juridik jepet afat për pagesën e gjobës, mirëpo për personat juridik nuk jepet mundësia për pagesën e dënimit me këste por nga ai menjëherë ekzekutohet nga trashëgimtarët apo nga themeluesit nëse ka pushuar së ekzistuari apo nuk ka pasuri për të paguar dënimin me gjobë.

1.4.Përcaktimi i vlerës ditore

Përcaktimi i sasisë së gjobës ditore është operacion pak i ndërlikuar që paraqet së pari mbledhjen e të dhënave nga ana e gjyqit për rrethanat personale dhe të pasurisë së kryerësit! Gjatë kësaj, gjyqi duhet të nisë nga të ardhurat e pastra ditore që autori i realizon ose mund t'i realizojë si dhe nga obligimet e tij familjare ose obligimet tjera dhe gjendja e tij pasurore në kohën e sjelljes së aktgjykimit (n.38 p.3). KPM në nenin 122 paragrafi. 37 përcakton edhe nocionin e të ardhurave ditore të pastra : me të ardhura ditore të pastra nënkuptojmë diçka plotësim në emër të rrogës ose plotësime tjera nga raporti i punës në emër të rrogës, si dhe të ardhura tjera neto nga kryerja e veprimtarive ose pasuri dhe të drejta pasurore; të ardhurat e pastra ditore fitohen me refuzimin e tatimeve ose obligimeve tjera ligjore; nëse gjyqi edhe në këtë mënyrë nuk mundet ta caktojë të ardhurën e pastër ditore, ose kjo do të shkaktonte zhagritjen e procedurës ku si bazë për përcaktimin e tij merret përfitimi ditor për një dite sipas rrogës mesatare në ekonomi në tre muajt e fundit të kohës së gjykimit. Për shkak të përcaktimit të vlerës së gjobës ditore, gjyqi mund të kërkojë raport nga banka, nga financat ose nga institucionet tjera, nga organet shtetërore dhe persona fizik të cilët janë të obliguar t'i japin raportet e kërkuara dhe

³¹ Osmani, Afrim; PENOLOGJIA, Shkup, 2917, fq.399

³² Po aty, fq.400

nuk mund të thirren në mbrojtje të fshehtësisë zyrtare (n.38 p.5).³³ Mund të parashihet se në fillim të praktikës gjyqësore do të ndeshet me pengesa të shumta në përcaktimin e vlerës së gjobës ditore, që varen kryesisht nga shkaqet e locuara jashtë sistemit gjyqësor. Për këtë, për zbatimin e dispozitave të reja të dënimit me gjobë është lënë më së gjati vocation legis pas miratimit të ndryshimeve të Kodit penale të RM-së në 2004 që gjyqtarët ta përvetësojnë teknikën e shqiptimit të dënimit me gjobë sipas sistemit të ri. Por, nëse këto probleme janë tejkaluar në disa shtete në tranzicion, nuk do të duhej të ekzistojë shkas i vërtetë pse mos të tejkalohen edhe në praktikën tonë gjyqësore. Për dënimin me gjobë i shqiptuar si dënim sekondar së bashku me dënimin me burgim ose me dënimin me kusht me të cilën është përcaktuar dënim me burgim,(n.33 p.3) Kodi penal i RM-së e mban sistemin e shumës fikse të të hollave: dënimi shqiptohet në shumë që nuk mund të jetë më e ulët se 20 euro dhe as më e madhe se 5000 euro në kundërvlerë të denarit pa zbatimin e të drejtave të mëhershme për gjoba ditore.³⁴

³³ Kambovski, Vllado; E DREJTA PENALE – PJESA E PËRGJITHSHME, Shkup, 2007, fq,487

³⁴ Osmani, Afrim; PENOLOGJIA, Shkup, 2017, fq.353

KAPITULLI I TRETË

1.Dënimi me gjobë si dënim kryesor ndaj personave fizik dhe juridik

1.1.Dënimi me gjobë ndaj personave fizik

Siç u përmend edhe më lartë dënimi me gjobë mund të shqiptohet si dënim kryesor dhe si dënim sekondar. Kur shqiptohet si dënim sekondar ajo mund të shqiptohet me dënimin me burgim ose me dënim me kusht me të cilën është e vertetuar dënimi me burgim.

Në nenin 38 paragrafi.1 të Kodit Penal thuhet: dënimi me gjobë shqiptohet në gjoba ditore, me çka numri i gjobave ditore nuk mund të jetë më i vogël se pesë e as më i vogël se 360 gjoba ditore. Vlera më e vogël e gjobës ditore është një euro në kundërvlerë të denarit, kurse më e madhja 5000 euro në kundërvlerë të denarit.³⁵ Ky sistem është krijuar në Skandinavi në fillim të shekullit 20, qëllimi i saj është heqja e dobësisë elementare e dënimit me të holla, e cila i godet qytetarët në varësi të pozitës së tyre ekonomike. Me këtë sistem përpiqet të kryhet individualizimi i dënimit me të holla, gjegjësisht me këtë sistem mundësohet për kryerësit e të njëjtës vepër penale, me shkallë të njëjtë të fajit, të shqiptohen dënime me të holla në shuma të ndryshme në varësi të gjendjes së tyre ekonomike. Kjo do të thotë se gjatë shqiptimit të dënimit me të holla gjyqi duhet të ketë kujdes në të ardhurat e kryerësit, në shpenzimet e tij, ngarkesat tjera materiale, gjegjësisht rrethanat që ndikojnë në zotësinë e tij për pagesë.³⁶ Pra, ky sistem shkon më shumë kah individualizimi i dënimit, që do të thotë se gjyqi ka parasysh gjendjen ekonomike të tij dhe të familjes së tij, që mendoj se është shumë e drejtë pasiqë, nuk është e drejtë që dikush me të ardhura shumë të ulëta mujore të paguaj njëjtë si ai person që fiton shumë më tepër sa që nuk i përbën asnjë problem ekonomik. Si dënim publik- juridik ai nënkupton pagimin e shumë s të hollave shtetit dhe jo obligim civil i kryerësit kundrejt shtetit. Për këtë, ai nuk mund të kompensohet, të bartet ose të meret nga tjetri ose të trashëgohet. Shiptimi i dënimit me gjobë staton në obligimin për pagesë ekskluzivisht shtetit dhe jo të dëmtuarit, kërkesat e pasurisë sigurohen me kthimin e lëndëve ose me konfiskimin e shfrytëzimit të pasurisë ose dëmshpërblimin e dëmtimit. Dënimi me gjobë gjithmonë thirret në shumë të caktuar të hollash dhe nuk mund të përcaktohet në disa vlera të tjera që nuk paraqesin të holla, siç është pagesa në letra me vlerë, sende të shtrenjta ose tërheqje të pasurisë.³⁷ **Kërkesa kryesore** - dënimi të jetë personal dhe të jetë shkurtim i disa të drejtave të kryerësit të veprës penale në raport me dënimin me gjobë, është relativizuar me faktin se ajo nuk ka gjithmonë natyrë të tillë dhe me rregull i tangon edhe anëtarët tjerë të familjes të cilët jetojnë me kryerësin. Kryerësi duhet të paguaj dënimin me të holla nga mjetet e tij personale, por asnjëherë nuk është përjashtuar obligimi i tij të plotësohet me përvetësimin e mjeteve të përbashkëta ose me mjete të huaja. E drejta penale bashkëkohore nuk disponon me instrumente përkatëse për shmangien e

³⁵ Neni 38, paragrafi 1 I Kodit penal të Republikës së Maqedonisë

³⁶ Сламков, Ѓорѓи; КАЗНЕНО ПРАВО-ОПШТ ДЕЛ, Скопје, 2009, стр.275

³⁷ Osmani, Afrim; PENOLOGJIA, Shkup, 2017, fq,350

karakterit të tillë kolektiv të dënimit me të holla! Kur kjo në mënyrë konsekuente do të përmbahej për kërkesën për karakter personal të këtij dënimi, do të duhej ta ndalojë por edhe ta sanksionojë ndihmën e kryerësit në pagesën e dënimit! Pagesa solidare vetëm me përjashtime vjen në sulm të ligjit penal, kështu p.sh. premtimi që më parë i dhënë kryerësit për ndihmë në pagesë për dënimin në të holla do të trajtohet si bashkëpjesmarrie ³⁸

1.2.Dënimi me gjobë për personat juridik

Dënimin me gjobë për personat juridik e shpjegon më së miri Kodi penal i RM-së, ku në nenin 96 është vënë përgjegjësia penale e personave juridik ndërsa në nenin 96 të këtij kodi janë vendosur dispozita të përgjithshme për matjen, shqiptimin, ekzekutimin si dhe lirimin nga dënimi me gjobë. Në nenin 122 paragrafi 6, jepet definicioni për personat juridik ku thuhet: me person juridik nënkuptohet: Republika e Maqedonisë, njesitë e vetëqeverisjes vendore, partitë politike, ndërmarrjet publike, shoqatat tregtare, institucionet dhe asociacionet e tjera, fondet, organizatat financiare dhe organizatat e tjera të caktuara me ligj të regjistruara si persona juridik dhe bashkësitë dhe organizatat e tjera të cilave u njihet cilësia e personave juridik. Si person i huaj juridik nënkuptohet ndërmarrja publike, institucioni, fondi, banka, shoqatat tregtare ose forma tjera të organizimit sipas ligjit të shtetit të huaj për të kryer veprimtari ekonomike, financiare, bankare, tregtare, shërbyese apo veprimtari tjera, që ka seli në shtet tjetër apo përfaqësi në Republikën e Maqedonisë, apo është themeluar si shoqatë, fond, bankë apo institucion ndërkombetar.³⁹

Në fillim do të flasim për përgjegjësinë e personave juridik, ku sipas nenit 28-a të Kodit penal të RM-së, në rastet e caktuara me ligj, personi juridik përgjigjet për veprën penale të kryer nga personi përgjegjës në personin juridik, në emër, në llogari apo në dobi të personit juridik. Personi juridik ka përgjegjësi edhe për veprën penale e kryer nga i punësuar i tij apo përfaqësuesi i personit juridik me të cilën është realizuar dobi e konsiderueshme nëse: ekzekutimi i konkludimit, urdhrit apo vendimit apo lejes tjetër e organit të menaxhimit, organit të udhëheqjes apo organit mbykëqyrës paraqet kryerje të veprës penale, ose 2. deri te kryerja e veprës ka ardhur për shkak të lëshimit të mbykëqyrjes së detyrueshme, organit të menaxhimit, organit mbykëqyres, ose 3. organi i menaxhimit, organi i udhëheqjes apo organi mbykëqyres nuk e ka penguar veprën penale ose e ka fshehur apo nuk e ka paraqitur para ngritjes së procedurës penale kundër kryerësit. Nën kushtet e këtij neni, penalisht përgjigjen të gjithë personat juridik me përjashtim të shtetit. Njesitët e vetëadministrimit lokal përgjigjen vetëm për veprat të kryera jashtë autorizimeve të tyre publike. Personi i huaj juridik ka përgjegjësi penale nëse vepra është

³⁸ Kambovski, Vllado; E DREJTA PENALE- PJESA E PËRGJITHSHME (përkthim), Shkup, 2007, fq, 485

³⁹ Neni 122 paragrafi 6 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë

kryer në territorin e Republikës së Maqedonisë, pa marrë parasysh se a ka përfaqësinë apo filialin e vet që kryen veprimtari në territorin e saj.⁴⁰

Sipas KPM-së, personit juridik mund t'i shqiptohen këto dënime:

dënim me gjobë,

ndalesa e përkohshme e kryerjes së ndonjë veprimtarie,

ndalese e përhershme për të kryer ndonjë veprimtari dhe

ndërprerja e ekzistimit të personit juridik (KPM, n28 dhe ,n.96-a)

Dënimi me gjobë është paraprë si kryesor kurse të tjerët si dënime sekondare që shqiptohen së bashku me dënimin me gjobë. Dënimi me gjobë shqiptohet në sasi që nuk mund të jetë më i vogël se 10 mijë denare dhe as më i madh se 30 milion denarë; për vepra të kryera nga levërdia, si dhe për veprat penale me të cilat realizohet apo shkaktohet dëm me përmasa të mëdha, mund të shqiptohet dënim me gjobë deri në shumën e dyfishtë të maksimumit të këtij dënimi ose në proporcion me lartësinë e dëmit të shkaktuar, gjegjësisht dobisë së realizuar, por më shumë deri te shuma e dhjetëfishtë e tyre.⁴¹ Mëtej në nenin 96-ë dhe 96-f të Kodit penal, spjegohet edhe shqiptimi më i butë i dënit dhe kufijtë e shqiptimit më të butë të dënit ku thuhet: *gjykata mundet personit juridik t'i shqiptojë dënim më të butë të gjobës nga dënimi i paraparë me nenin 96-ç te këtij kodi, nëse: 1.ligji parasheh ndëshkim më të butë; 2.ligji parasheh mundësi për lirim nga dënimi, kurse gjyqi nuk do ta liroje personin juridik nga dënimi, dhe 3. vlerëson se ekzitojnë rrethanat veçanërisht lehtësuese se me dënimin më të butë mund të arrihet qëllimi i ndëshkimit.* Kur do të plotësohen kushtet për shqiptimin e dënit më të butë të gjobës nga neni 96-dh të këtij kodi, gjyqi do të shqiptojë dënim më të butë brenda ketyre kufijve: 1. për veprën penale për të cilën personit juridik mund ti shqiptohet dënim deri në 500.00 denarë apo deri në shumën e dyfishtë të dobisë apo dëmit, mund të shqiptohet dënim më i butë deri në 100.000 denarë, 2. për veprën penale për të cilën personit juridik mund t'i shqiptohet dënim deri në një milion denarë apo deri në shumën e pesëfishtë, dënimi me gjobë mund të shqiptohet në dënim më të butë deri në 200.000 denarë apo deri në shumën e dyfishtë të dobisë apo dëmit, dhe 3.për veprën penale për të cilën personit juridik mund t'i shqiptohet dënim me gjobë më së paku një milion denarë apo deri në shumën e dyfishtë të dobisë apo dëmit, dënimi me gjobë mund t'i shqiptohet si dënim më i butë deri në 300.000 denarë apo deri në shumën e pesëfishtë të dobisë apo dëmit.⁴² Ndërsa në nenit 96-g te KPM-së thuhet: personi juridik mund të lirohet nga dënimi nëse personi përgjegjes në personin juridik, organi i meaxhimit apo i udhëheqjes apo organi mbykëqyrës pas veprës së kryer penale vullnetarisht e paraqet kryerësin e veprës penale apo e kthejnë dobinë

⁴⁰ Po aty, neni 28

⁴¹ Po aty, neni 96-a paragrafi 1 dhe 2

⁴² Po aty, neni 96-ë paragrafi 1 dhe 96-f paragrafi 1 dhe 2

pasurore apo i menjanojnë pasojat e dëmshme të veprës apo në mënyrë tjetër i kompensojnë pasojat e dëmshme.⁴³

Në vazhdim do të paraqes një rast ku si i dënuar me gjobë paraqitet personi juridik që ka ndodhur me 17.01.2012, me aktgjykimin e sjellur nga Gjykata Themelore e Tetovës, ndaj të pandehurve: personi juridik “GUDALAT” GOSTIVAR dhe ndaj të pandehurit Xh.F nga qyteti i Gostivarit, të cilët kanë kryer veprën penale Mashtrim doganor e cila është paraparë në nenin 278 të Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, ku ndaj personit është shqiptuar dënim me gjobë, ndërsa personit fizik gjykata i’a vërteton dënimin me burgim prej 2 viteve por i shqipton dënim me kusht nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër të re penale në kohë prej 5 viteve dhe i shqipton dënim me gjobë prej 200 gjobave ditore.

Rasti nr.1

K-76/12

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

GJYKATA THEMELORE NË TETOVË- si gjykatë penale e shkallës së parë në përbërje nga gjykatësi J.V- si Kryetar i këshillit, gjykatësi S.I dhe gjykatësit porotë M.P, S.G dhe M.J- Si anëtarë të këshillit, me procesverbalisten A.B, duke vendosur në bazë te propozimakuzyes së Prokurorisë së përgjithshme të Tetovës me nr.217/11 të datës 17.01.2012, kundër te pandehurve: Personi juridik “GUDALAT” SH.P.K Gostivar- për veprën penale Mashtrim doganor sipas nenit 278-a dhe nenit 45 të Kodit penal dhe kundër XH.F nga Gostivari- për veprën penale Mashtrim doganor sipas nenit 278-a dhe nenit 45 sipas Kodit penal, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, publik dhe gojor në prani të prokurorit publik B.A, përfaqësuesit të autorizuar të personit juridik SH.K, mbrojtësit të pandehurit- avokat L.R dhe i pandehuri në datë 17.06.2013 shpalli këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

1.Personi juridik “GUDALAT”. Gostivar, rruga “Ilindenska” nr 165, me EBDS-YYYYYYY

2.XH.F nga babai M.F dhe nëna E.F, i lindur më 03.10.1997, në fshatin B, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Maqedonisë, me shkollim të mesëm, i martuar, prind i 2 fëmijëve, i pa denuar.

⁴³ Po aty, neni 96-g paragrafi 1

JANË FAJTOR

Për shkak se:

Personi juridik i pandehur GUDALAT dhe i pandehuri XH.F nga Gostivari, si person përgjegjës në personin juridik, në periudhën prej vitit 2006-2007 dhe në fillim të vitit 2009 në Tetovë, duke shfytëzuar të njejtat mundësi, duke importuar mall nga kompania PRASSINA PRODUCTS B.V, prej Holande, pjesërisht i ka ikur pagesës së të dhënave dhe tatimit të cilat paguhen gjatë importit, për të cilat janë të obliguar me ligj, shuma prej 7.576.721 denarë në emër të doganës dhe tatimit të vlerës së shtuar, çka paraqet një shumë të madhe, në mënyrë që para zyrës doganore në Tetovë kanë dhënë të dhëna të rrejshme për importimin e mallit të shumëllojshëm dhe renditja e gabuar e tarifës.

DËNON

Me dënim me të holla në lartësi prej 300.000.00 denarë. Dënimi me të holla.

Të pandehurit XH.F ne pajtim me nenin 3,33,35,39,40 dhe 41 te Kodit penal i:

VËRTETON

Dënim me burgim me kohëzgjatje prej 2 viteve

Në pajtim me nenin 49 dhe 50 të Kodit penal, i shqiptohet:

DËNIM ME KUSHT

Dënimi i vërtetuar me kusht nuk do të shqiptohet nëqoftëse i pandehuri nuk do të kryej vepër të re penale në afat kohor prej 5 viteve.

DËNON

Me dënim me të holla në lartësi prej 200 gjobave ditore. Lartësia e një gjobe ditore është 10 EURO ose gjithësej 2.00 EURO në kundërvlerë të denarit prej 123.000.00. Dënimin me gjobë ta paguaj në afat prej një muaji pas plotfuqishmërise së aktgjykimit, me atë që nëse nuk e paguan do të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme, ndërsa nëse nuk mund të ekzekutohet edhe në mënyrë të dhunshme atëhere do të zëvendësohet me burgim, ashtu që për çdo gjobë ditore do të parashihet një ditë burgim, me atë që burgu nuk mund të jetë më i gjatë se 6 muaj.

TË PAGUAJNË

Secili, në emër paushallit penal, Shumën nga 4.000 denarë në afat prej 30 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Në emër të shpenzimeve të procedurës, shuma prej 13.176,00 denarë, në afat prej 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit

Ky është një aktgjykim ku janë shpallur fajtor edhe personi juridik edhe personi përgjegjës në personin juridik, për veprën penale mashtrim doganor, e paraparë në nenin 278 të Kodit penal. Gjithashtu me këtë aktgjykim vërejmë se është vepër penale e vazhduar nga shkaku së është kryer në disa periudha të caktuara kohore dhe me disa veprime të caktuara. Ky aktgjykim përmban dispozitivin dhe arsyetimin, poashtu dënimin i cili është dënim me gjobë për personin juridik, ndërsa për personin fizik vërtetohet dënimi me burg prej 2 viteve, ndërsa gjykata i shqipton dënim me kusht, dhe i shqipton dënim me gjobë me 200 gjoba ditore me nga 10 euro për çdo gjobë ditore në kundërvlerë të denarit, ndërsa personi juridik dënohet me 300.000,00 denarë.

1.3. Ekzekutimi ose zëvendësimi i dënimit me gjobë me burgim

Duke i parë përparësitë e dënimit me gjobë, e drejta penale bashkëkohore është e orientuar që në të gjitha rastet e veprave penale, ku nuk është më se i domosdoshëm dënimi me burgim, të shqiptohen dënime me gjobë, kompensimi material i dëmit dhe surrogatet e tij. Kështu, duke e respektuar konceptin e kufizimit të dënimit me burgim, tani në të drejtat penale bashkëkohore, dënimi me gjobë është njëri ndër dënimet më të rëndësishme dhe më të shpeshta. Për këtë arsye tani i kushtohet rëndësi e madhe dënimit me gjobë dhe çështjeve lidhur me këtë dënim me qëllim që të arrihet efekti i tij.⁴⁴ Në sistemet bashkëkohore penale – juridike, ekzistojnë zgjidhje të ndryshme në raport me problemin që del kur i dënuari nuk mundet ose nuk do që ta paguaj dënimin me gjobë! Por të gjitha ulen në masë plotësuese të detyrueshme (punë në dobi të përgjithshme) me të cilin i dënuari detyrohet të paguaj, kurse nga ana tjetër mbahet karakteri dënues i gjykimit! Pikërisht, reaksioni detyrues plotësues i mos pagesës së dënimit me të holla dallon këtë sanksion, si dënim publik nga cilido obligim tjetër qytetar! Në rregullimin e pasojave nga mos pagesa e dënimit me të holla, KPM niset nga parimi i veprimi! Së pari, nëse i dënuari nuk e paguan vullnetarisht dënimin me të holla në afatin e caktuar, gjyqi mundet ta vazhdojë atë afat nëse gjen se ekzistojnë arsye. Nëse përkundër kësaj vlerëson se i dënuari nuk do që ta paguaj, mund të urdhërojë realizimin e dhunshëm të tij në procedurë të përcaktuar me ligj. Në atë

⁴⁴ Salihu, Ismet; E DREJTA PENALE – PJESA E PËRGJITHSHME, Prishtinë, 2003, fq.456

rast, dënimi me të holla sipas dispozitave të ligjit të procedurës ekzekutive realizohet nga pasuria e të dënuarit. Nëse më në fund dhënia e afatit të ri i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tre muaj ose kryerja e dhunshme ka mbetur pa sukses, gjyqi e realizon dënimin ashtu që për çdo ditë gjobë ditore përcakton një ditë burg! Kështu që burgu i ndryshueshëm i përcaktuar nuk mund të jetë më i gjatë se 6 muaj (n.38 p.2). Nëse i dënuari paguan vetëm një pjesë të dënimit me të holla, mbetja tjetër shndërrohet në burg dhe nëse i dënuari e paguan mbetjen e dënimit, vuajtja e dënimit ndërpritet (n.38a p.3). Zëvendësimi i mospagimit të dënimit me burg është zgjidhje e padrejtë! Dënimi me gjobë në fakt mund t'i shqiptohet personit i cili nuk ka qenë në gjendje aspak ta paguaj, ashtu që paraqitet vetëm si i tërhtortë (dhe jo ekonomik) i shqiptimit të dënimit me burg! Sipas kësaj, me zëvendësimin e dënimit me të holla në dënim me burg që më parë janë të dënuar siç duket të varfërit. Por, pavarësisht nga mos drejtshmëria, zgjedhja e zëvendësim – burgut është i papranueshëm në shumë legjislatura bashkëkohore (amerikane, angleze, gjermane, franceze). Zëvendësim – burgu nuk është lloj special i dënimit me burg, por modalitet i realizimit të dënimit me të holla, lloj i burgut – borxh që zgjat derisa i dënuari të paguaj dënimin me të holla! Duke pasur parasysh se përbëhet në heqjen e lirisë dhe për të vlejné rregullat për vuajtjen e dënimit me burg me përjashtim se lirimi me kusht, amnistisë, mund të jepen vetëm për dënimin me të holla dhe jo edhe për zëvendësimin me burg! Kufizimi ligjor i kohëzgjatjes së burgut zëvendësues më së gjati deri në gjashtë muaj do të thotë se të dënuarit i falet mbetja e dënimit me të holla e cila e tejkalon numrin e gjobave ditore të shndëruara në burg me kohëzgjatje të tillë (180 gjoba ditore!).⁴⁵ Domethëne nëse i dënuari nuk i respekton afatet e dhëna për pagesën e gjobës, atëherë ajo bëhet me zëvendësim me burg, mirëpo edhe pasi të filloje me vuajtjen e dënimit me burg, përsëri i jepet mundësia që në moment që e ben pagesën menjëherë lirohet nga vuajtja e dënimit me burg.

⁴⁵ Kambovski, Vllado; E DREJTA PENALE- PJESA E PËRGJITHSHME (përkthim), Shkup, 2007, fq.489

KAPITULLI I KATËRT

1.Aspekte kriminologjike të dënimit me gjobë

Në këtë kapitull do të flitet për fenomenet që paraqiten gjatë shqiptimit të dënimit me gjobë, etiologjinë e kryerjes së veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë si dhe për ekzekutimin e dënimit me gjobë, të gjitha keto në kuadër të territorit të Gjykatës Themelore të Tetovës në periudha të caktuara.

1.1.Fenomenologjia e shqiptimit të dënimit me gjobë në Territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga viti 2007-2012

Fenomenologjia kriminale është pjesë e kriminologjisë dhe merret me studimin e formave të paraqitjes së kriminalitetit, me struktura dhe dinamikën e tij. Me çështjen e fenomenologjisë kriminale janë marrë shumë autorë. Kësisoj, këta autorë, vërtetojnë se fenomenologjia kriminale duhet të koncentrohet në studimin e statikës, dinamikës dhe tipologjisë së formave të manifestimit të krimit dhe sjelljes delikuede. Po ashtu, sipas tyre, ajo duhet të merret edhe me përshkrimin e menyrës së kryerjes së krimeve të ndryshme, me studimin dhe njohjen e personalitetit të kryerësve respektivisht me studimin e jetës së delikudentëve dhe, në fund, me tipologjinë dhe klasifikimin e kriminelëve. Autori i njohur **Hans Gros**, mendon se **fenomenologjia kriminale duhet të merret me studimin e simptomeve të jashtme të kriminalitetit**. Mendimtari tjetër Ernest Selig, mendon se fenomenologjia kriminale nënkupton përshkrimin e formave speciale të kryerjes së krimeve të ndryshme, p.sh. teknikën e kryerjes së vjedhjeve me thyerje, mënyrën e falsifikimit, studimin e vetive dhe gjesteve të ndryshme të delikudentëve etj. Në këtë drejtim, ai mendon se fenomenologjia kriminale duhet posaçërisht të merret me studimin dhe analizën e tipave të kriminelëve të ndryshëm, me kriminelët profesionistë me mënyrën e sjelljes, e posaçërisht me analizën dhe studimin e zhargonit të tyre të veçantë të komunikimit. Roland Grasberger, gjithashtu thekson se fenomenologjia kriminale studion morfologjinë e krimit gjegjësisht manifestimin e tij në botën e jashtme.⁴⁶ Duke patur parasysh se dënimi me gjobë si dënim pasurorë bën pjesë në veprat penale të lehta dhe shqiptohet më shumë për vepra penale të rrezikshmërisë më të ulët, do të spjegoj më gjërësisht veprat penale për të cilat shqiptohet dënimi me gjobë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga periudha 2007-2012. Pra, si vepra penale që më së shumti paraqiten kur shqiptohet dënimi me gjobë janë, **veprat penale kundër sigurisë në trafik**, më konkretisht vepra penale **rrezikimi i sigurisë në trafik**, e cila është e paraparë në nenin 297 të Kodit Penal si dhe **veprat penale kundër pasurisë**, më konkretisht **vepra penale e vjedhjes**, e paraparë në nenin 235 të Kodit penal dhe vepra penale e **mashtimit**, e paraparë në nenin 247 të Kodit penal. Gjithashtu për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë, sipas hulumtimeve

⁴⁶ Halili, Ragip; KRIMINOLOGJIA, Prishtinë, 2008, fq.115

të bëra në regjistrin penal të Gjykatës Themelore të Tetovës, gjatë periudhës 2007-2012 në shumë raste paraqitet vepra penale **heqja ose dëmtimi i vulës apo shenjës zyrtare**, e paraparë në nenin 389 të kodit penal, vepër kjo e cila bën pjesë në veprat penale kundër rendit publik, dhe për të cilën do të paraqes një rast i cili ka ndodhur në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës.

1.1.1. Veprat penale kundër sigurisë në komunikacion

Trajtimi i delikuencës në trafik, si në teori ashtu edhe në praktikën juridike-penale dhe kriminologjike, është mjaft i larmishëm. Disa vende, këto sjellje dhe veprime, i trajtojnë si vepra penale të rrezikimit dhe sigurisë së trafikut publik. Ndërsa vendet tjera i trajtojnë si kundërvajtje. Vërehet, se shumica e vendeve dhe legjislacioneve botërore megjithë atë bëjnë dallimin mes veprave penale dhe kundërvajtjeve në trafik. Mirëpo, që të gjitha këto veprime dhe sjellje në jetën e përditshme parashihen dhe shprehen me nocione deliktet në trafik si sinonim i të gjitha veprimeve të rrezikshme dhe të kundërligjshme në trafikun publik, atë automobilistik, hekurudhor, detar apo ajror. Faktikisht, në mes këtyre formave të delikuencës në trafik ka dallime të konsiderueshme, sidomos përnga pasojat dhe viktimat të cilat janë të pranishme. Dihet se, në këtë drejtim, më së shumti ka viktimat në të ashtuquajturin trafik automobilistik apo trafik rrugor, prandaj kur flitet për kriminalitetin në trafik, rëndom mendohet për trafikun automobilistik. Lidhur me delikuencën dhe veprat penale në trafik, shtrohet çështja e përgjegjësisë së kryerësve të këtyre sjelljeve delikuede. Është e ditur se shumica e këtyre sjelljeve kriminale kryhen nga pakujdesia e jo me dashje. Prandaj, me të drejtë shtrohet çështja e mënyrës së përgjegjësisë dhe llojit të sanksionit penal që duhet aplikuar ndaj personave të tillë. Nga literatura juridiko- penale dihet se personat të cilët kryejnë krimet në trafik, përgjigjen veçmas në rastet e konsumit të alkoholit, drogës dhe pijeve tjera narkotike, për shkak se ata është dashur që më parë të jenë të vetëdijshëm se vënia në atë gjendje mund të sjellë deri te paraqitja e veprave penale dhe fatkeqësive në trafik. Meqenëse këto delikte bëhen nga pakujdesia edhe gjatë matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, paraqiten zgjidhje të ndryshme në praktikë, që dallohen nga trajtimi veprave penale tjera. Zakonisht, dënimet janë më të buta. Shpeshherë edhe tretmani i këtyre delikudentëve është më i butë nëpër entet ndëshkimore – përmirësuese.⁴⁷ Sipas të dhënave statistikore, në botë nga aksidentet në komunikacion vdesin rreth 300.000 njerëz në vit nga të cilët në Evropë rreth 30%; në SHBA 25%; Azi 25%; Afrikë 15% dhe Australi 2%. Në vendet me zhvillim të lartë në SHBA, Suedi, Angli, Gjermani dhe Francë në 3000-4000 vetura i bie se vdes një person, në vendet me zhvillim të mesëm Greqi, Portugali, Hungari në 1000 vetura nga një viktimë, ndërsa në vendet e pazhviluara Keni, Etiopi, Pakistan dhe Nigeri në 100 vetura nga një viktimë.⁴⁸ Ndërsa në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave statistikore të Ministrisë për punë të brendshme aksidentet në komunikacion nga viti 2002 deri në vitin 2010

⁴⁷ По аты, fq.222

⁴⁸ Крстаноски, Миладин; KRIMINALITET I DETEKCIJA, Ohrid, 2010, str.246

do ti paraqes në mënyrë tabelare, ku do të shohim sa është numri i aksidenteve me pasoja të lëndimit dhe me pasoja për vdekje.

Tabela nr.1

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Aksidente në komunikacion me persona të vdekur	144	105	133	123	130	147	155	149	134
Aksidente në komunikacion me persona të lënduar	1.484	1.821	1.854	2.698	3.183	3.890	4.248	4.204	4.089
Gjithësej	1628	1926	1987	2821	3313	4037	4403	4353	4223

49

Kodi penal i RM-së, në nenin 297 numëron disa vepra penale kundër sigurisë në komunikacionin publik, ku janë paraparë edhe dënime me gjobë si dënime kryesore. Ndër to mund të përmëdim: *Rrezikimi i sigurisë së trafikut me veprim ose mjet të rrezikshëm, të ushtruarit e pandërgjegjshëm të mbykëqyrjes së trafikut, prishja ose menjanimi i shenjës që shërben për siguri në trafikun ajrorë.*

Ndër veprat më të shpeshta penale që janë kryer në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga periudha 2007-2012 kur shqiptohet dënimi me gjobë paraqitet vepra penale **rrezikimi i sigurisë në trafik**. Ky lloj kriminaliteti sipas nenit 297 të Kodit penal, kryhet nga personat pjesëmarrës në komunikacion që nuk u përmbahen dispozitave dhe me atë rrezikojnë trafikun publik ashtu që do të sjellë në rrezik jetën ose trupin e njerëzve ose pasurinë në vëllim të konsiderueshëm, dhe për të cilën gjë ndonjë personit do t'i shkaktohet lëndim trupor ose do të shkaktohet dëm i konsiderueshëm i pasurisë. Për këtë veprë si dënim kryesor parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet.⁵⁰ Ky lloj kriminaliteti jam i mendimit se është një fenomen i çuditshëm në Republikën e Maqedonisë, por edhe në Territorin e Gjykatës themlore të Tetovës, nga shkak se në komunikacion marrin pjesë jo vetëm personat e rritur, që kanë të drejtë apo leje të vozitjes, por edhe të miturit që ende nuk kanë arritur moshën që të pajisen me leje për vozitje por që vozisin rregullisht. Këta të rinj shpeshherë janë edhe kryerësit e shumë veprave penale kundër sigurisë në komunikacion, nga mospërvoja dhe padituria se si duhet të sillet në komunikacion.

⁴⁹ <http://www.mvr.gov.mk/analiza/soobrakjaj/53>

⁵⁰ Neni 297 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë

1.1.2.Veprat penale kundër pasurisë

Me kriminalitet kundër pasurisë, nënkuptohen të gjitha veprimet që cenojnë dhe rrezikojnë pasurinë private dhe shtetërore. Si vepra penale më të njohura, gati në të gjitha Kodet Penale bashkëkohore numërohen: **vjedhjet e imëta, vjedhjet e zakonshme, vjedhjet e rënda, vjedhjet me grabitje, vjedhjet me thyerje, fshehja e tatimeve, plaçkitja, vjedhja e automjeteve, marrja e gjësendeve të huaja, mashtrimi keqpërdorimi i besimit, fshehja etj** Krimet kundër pasurisë janë të njohura që nga kohërat më të lashta. Këto krime bëjnë pjesë në kriminalitetin klasik. Mirëpo kjo nuk do të thotë se format e paraqitjes së disa krimeve nuk kanë pësuar ndryshime dhe se nuk janë lajmëruar forma të reja. Fjala vjen thuhet se me zhvillimin e teknikës, elektronikës, pajimeve më të reja elektronike e kompjuterike dhe përsosjes së industrisë bashkëkohore e veçmas asaj automobilistike, telefonisë, kompjuterëve dhe teknikës më të re të sofistikuar, është mundësuar që krimet kundër pasurisë të kryhen më shpejtë dhe të vështirësohet zbulimi i kryerësve të tyre. Paraqitja e automobilistike ka ndikuar në shtimin e një vargu krimesh kundër pasurisë si vjedhjeve, rrëmbimeve, vjedhjeve nëpër shtëpi mallrash, banka dhe vjedhja e vetë automobilave. Pastaj paraqitja e kompjuterëve dhe internetit ka nxitur formën e reja të vjedhjeve që më parë nuk kanë mundur të paramendohen.⁵¹ Me vepra penale kundër pasurisë nënkuptohen ato vepra penale që shfaqen në marrjen e sendit të huaj në mënyrë të kundërligjshme të kryera me dashje dhe me qëllim përfitimi material për vete ose në dobi të personave tjerë ose në dëmtimin apo shkatërrimin e saj.⁵² Ndërsa sa i përket shqiptimit të dënimit me gjobë për veprat penale kundër pasurisë, në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga viti 2007-2012 më së shumti paraqiten: vepra penale e vjedhjes dhe vepra penale e mashtrimit. Pra, për këto vepra janë shqiptuar më së shumti dënime me gjobë, nga shkak se këto llogariten si vepra më të lehta kundër pasurisë. Në vazhdim do të spjegojmë veç e veç këto dy lloje të veprave penal duke filluar nga vepra penale e vjedhjes dhe më pas për veprën penale të mashtrimit.

Vjedhja është një ndër veprat penale kundër pasurisë së personave fizik dhe juridik, e njohur historikisht në vende të ndryshme të botës dhe e përhapur kudo. Vepra konsiderohet se është kryer kur ndokush i'a merr tjetrit sendin e huaj të luajtshëm me qëllim që në mënyrë të kundërligjshme ta përvetësojë. Për këtë veprë penale është paraparë dënim me gjobë apo dënim me burgim deri në 3 vjet.⁵³ Kryerësit e këtij lloji kriminaliteti i kanë këto karakteristika: Vjedhësit veçanërisht janë të etabluar në “zanatin” e tyre. Sipas shumë hulumtuesve të kësaj lëmie, Barlow, Singer, Sutherland, ato posedojnë njohuri të caktuara në “veprimtarinë” e tyre, nga vjedhja krijojnë profesionin e tyre, kanë zotësi për manipulim me njerëz, mendojnë se nuk e lendojnë askënd, me vjedhje e kompensojnë padrejtësinë në shoqëri (zakonisht thonë: tregtarët dhe avokatët kanë leje për vjedhje, ndërsa vjedhësit nuk kanë leje, i urrejnë delikuentët e

⁵¹ Halili, Ragip; KRIMINOLOGJIA, Prishtinë. 2008, fq.205

⁵² Zejneli, Ismail, E DREJTA PENALE- PJESA E POSAÇME, Tetovë, 2007, fq.111

⁵³ Po aty, fq.112

dhunshëm, veçanërisht ato seksual etj.⁵⁴ Për këtë vepër si kryerës më të shpeshtë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës paraqiten personat e moshës më të re dhe ka shumë raste që paraqiten si kryerës recidivist.

Tabela nr.2 Numri i dënimeve me gjobë të shqiptuara për veprën penale të vjedhjes në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga viti 2007-2010

Viti	2007	2008	2009	2010	Gjithesej
Numri i dënimeve me gjobë për veprën penale të vjedhjes	33	49	86	49	217

55

Nga tabela shihet se gjatë viti 2007 janë shqiptuar gjithësej 33 dënime me gjobë për veprën penale të vjedhjes, ndërsa në vitin 2008 ky numër është pothuajse i njejtë, ku janë shqiptuar gjithësej 49 dënime me gjobë për veprën penale të vjedhjes.. Viti 2009 shënon rritje në krahasim me dy vitet e kaluara dhe janë shqiptuar gjithësej 86 dënime me gjobë. Ndërsa në vitin 2010 gjithësej janë shqiptuar 49 dënime me gjobë për veprën penale të vjedhjes.

Mashtrimi është veprim i kryerësit i cili me qëllim që për vete apo për tjetër të sigurojë dobi të paligjshme psurore do të sjellë dikë në mashtrim me paraqitje të rrejshme ose me fshehje të fakteve ose do të mbajë në mashtrim dhe me të do ta shtije të kryej apo mos të kryej diçka që është në dëm të pasurisë së tij apo të huaj, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Te ky lloj kriminaliteti paraqiten tipologji interesante të kryerësve të kësaj veprë. Në mashtrimet-rrenat e tyre kryerësit janë aq bindës “njerëz të mire“, mendjeprehtë, në “nivel“ në pikpamje të rrenës, shprehës, me fantazi befasuese, të cilëve thjeshtë nuk mund të mos u besohet.⁵⁶ Vepra penale Mashtrim parashihet në nenin 247 paragrafi 1. të kodit penal të RM-së ku thuhet: ai i cili me qëllim për vete apo për tjetër që të sigurojë dobi të paligjshme psurore do të sjellë dikënd në mashtrim me paraqitje të rrejshme ose me fshehje të fakteve ose do ta mbajë në mashtrim dhe me të do ta shtije të kryejë apo mos të kryejë diçka që është në dëm të pasurisë së tij apo të huaj, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet.⁵⁷ Për këtë vepër në territorin e Gjykatës Themelore paraqitet si vepër e rallë kur shqiptohet dënimi me gjobë si dënim kryesor, por që kryhet nga persona kryesisht të papunë dhe me shkollim të përgjysmuar, që nuk shohin rrugë tjetër përfitimi dhe mashtrimin e konsiderojnë si formë më të shpejtë për të arritur qëllimet e

⁵⁴ Крстаноски Миладин; КРИМИНАЛИТЕТ И ДЕТЕКЦИЈА, Охрид, 2010, стр.194

⁵⁵ Të dhëna nga Gjykata Themelore e Tetovës

⁵⁶ Крстаноски Миладин; КРИМИНАЛИТЕТ И ДЕТЕКЦИЈА, Охрид, 2010, стр.197

⁵⁷ Neni 247 paragrafi 1 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë

caktuara. Nga kjo që u tha më lartë shohim se veprat penale për të cilat shqiptohet dënim më gjobë janë vepra të rrezikshmërisë më të vogël, në krahasim me veprat penale të tjera. Dënimi me gjobë parashihet për ato vepra për të cilat mund të shqiptohet edhe burgim deri në tre vjet. Pra dënimi me gjobë kryesisht shqiptohet për veprat penale kundër sigurisë në komunikacion dhe kundër pasurisë.

Në vazhdim do të paraqes në mënyrë tabelare numrin e veprave penale kundër pasurisë dhe kundër sigurisë në komunikacion në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 2007-2012.

Tabela nr.3 Veprat penale kundër pasurisë dhe veprat penale kundër sigurisë në komunikacionin publik në territorin e Republikës së Maqedonisë nga periudha 2007-2012

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Gjithësej
Veprat penale kundër pasurisë	3,888	3,770	3,952	3,612	3,850	3,652	22,724
Veprat penale kundër sigurisë në komunikacion	1,753	1,885	1,903	1,764	1,770	1,595	10,670

58

Poashtu në këtë punim do të elaboroj edhe personalitetin e kryerësve të veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë, duke filluar nga:

- **mosha,**
- **gjinia dhe**
- **statusi social.**

Mosha është gjithashtu karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal. Të dhënat statistikore nga praktika gjyqësore dhe nga shënimet e kërkimeve empirike kriminologjike, flasin se me veprime dhe sjellje kriminale merren persona të moshave të ndryshme. Siç dihet, mosha e kryerësve të veprave penale, përkatësisht sjelljeve kriminale, mund të ndahet sipas përcaktimeve ligjore pozitive. Sipas ligjeve pozitive penale të vendeve të ndryshme, mosha e kryerësve të veprave penale, ndahet në mosha të personave të mitur dhe personave të rritur. Mirëpo brenda këtyre dy ndarjeve kryesore, kemi edhe ndarje tjera. Mosha e mitur ndahet në të mitur të rinj, e cila përfshin moshën prej 14-16 vjet dhe në të mitur të rritur që përfshin moshën prej 16-18 vjet. Si moshë e rritur konsiderohet mosha prej 18 e deri në vdekje të individit. Nëse shikohen të

⁵⁸ Enti shtetërorë për statistikë i Republikës së Maqedonisë

dhënat statistikore, gjyqësore dhe të dhenat empirike kriminologjike ne botë, vërehet se moshë më prezente në veprimet kriminale janë moshat prej 25-30 , pastaj grupi i moshës 30-50 dhe më pak grupi i moshës mbi 60 vjet⁵⁹. Gjithashtu sipas të dhënave statistikore në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës numri më i madh i kryerësve të veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë janë persona të moshës madhore, pa përjashtuar edhe personat e moshës më të re, edhe pse personat e moshës së rritur përbëjnë shumicën e veprave të kryera penale kur shqiptohet dënimi me gjobë.

Gjinia dhe perktësia seksuale, në pjesëmarrjen e kriminalitetit, gjithashtu vështrohet në literature krimnologjike, dhe interpretohet nga këndvështrime të ndryshme. Ekziston një përshtypje e përgjithshme, në bazë të të dhënave statistikore kriminale dhe praktikës gjyqësore, se kriminaliteti është një dukuri tipike e gjinisë mashkullore. Sipas të dhënave statistikore, nga literatura kriminologjike, në vendet e ndryshme, përqindja e pjesëmarrjes në kriminalitet të përgjithshëm e personave të gjinisë femërore, sillet nga 8-10% të të gjithë pjesëmarrësve.⁶⁰ Edhe për veprat penale për të cilat shqiptohet dënimi me gjobë, kryerësit e veprave penale janë meshkujt ata të cilët e përbejnë shumicën absolute të veprave penale. Sipas të dhënave statistikore të marra nga gjykata themelore e Tetovës, numri i meshkujve përbën shumicën e numrit të përgjithshëm të veprave penale për të cilat parashihet dënim me gjobë. Mirëpo edhe femrat nuk janë krejtësisht të përjashtuara nga kryerja e veprave penale, edhe pse dukshëm më pak se meshkujt.

Gjendja sociale, në literaturën kriminologjike, një kohë të gjatë ka dominuar mendimi se kriminaliteti është karakteristikë për shtresat e ulëta, sidomos për kategorinë e punëtorëve dhe njerëzve të papunë dhe të varfër. Këto konstatime janë bazuar në shënime mbi numrin e personave ndaj të cilëve janë bërë kallzime penale, janë ngritur aktakuza ose janë shqiptuar dënime nga gjykata.⁶¹ Edhe pse shteti jonë është shtet social, përsëri është një ndër vendet me raste më të shumta sociale në rajon, ku qytetarët përballen me vështirësi të shumta, duke nisur nga papunësia, pagat e ulëta dhe pensionet e kështu me rradhë. Kjo ndikon shumë që kjo kategori e qytetarëve të kryejnë vepra të ndryshme penale, e posaçërisht numri i tyre vërehet shumë edhe te veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë. Në territorin e gjykatës themelore të Tetovës gjatë periudhës 2007 – 2012 vërehet se numri më i madh i kryerësve të veprave penale për të cilat parashihet dënim me gjobë, vjen nga kjo kategori e qytetarëve. Posaçërisht ky numër vërehet te vepra penale e vjedhjes. Pra, mendoj se nga shkak i pamundësive për të përballuar vështirësitë ekonomike në shumë raste e shohin si rrugë të vetme për të siguruar kafshatën e gojës për vetë apo për familjet e tyre.

⁵⁹ Halili Ragip, KRIMINOLOGJIA, Prishtinë, 2008, fq.129

⁶⁰ Po aty, fq.131

⁶¹ Po aty, fq.133

1.2.Etiologjia kur shqiptohet dënimi me gjobë

Studimet etiologjike meren me faktorët objektiv-egzogjen dhe subjektiv-endogjen të cilët e kushtëzojnë fenomenin e kriminalitetit dhe dukurive tjera antisociale dhe negative në një shoqëri. Vetë fjala etiologji do të thotë shkencë mbi thelbin, esencën, rrënjën dhe shkaqet e një dukurie.

Për t'i arritur këto detyra dhe qëllime, etiologjia kriminale duhet të ndërmarrë doemos analiza dhe veprime interdisiplinore, duke i studiuar dhe njohur proceset e ndryshme në shoqëri dhe ndikimet e tyre në sjelljet kriminale. Në këtë mënyrë, etiologjia kriminale angazhohet për njohjen, zbardhjen dhe të kuptuarit e proceseve të cilat ndikojnë në formimin negativ të personalitetit dhe shpjen deri te aktiviteti i tij kriminal. Pra, etiologjia kriminale angazhohet për shpjegimin dhe ndriçimin e rrugëve të cilat shpjen deri te kriminaliteti. Nga analizat, studimet dhe shpjegimet etiologjike të shkaqeve të dukurisë së kriminalitetit, varen shumë edhe zgjedhjet e mjeteve dhe metodave për luftimin dhe pengimin e tij, e po ashtu edhe vet procesi i risocializimit dhe riedukimit të personave të dënuar në ente-ndëshkimore përmirësuese.⁶² Duke pasur të gjitha këto, mund të theksohet se nga shkalla e zhvillimit të njohurive etiologjike mbi kriminalitetin, varet edhe vetë vendi dhe roli i kriminologjisë si shkencë e luftimit të kriminalitetit, sepse dihet që qëllimi i saj është njohja dhe zbardhja e së vërtetës mbi shkaqet, mënyrën dhe rrethanat e paraqitjes së kriminalitetit. Këto çështje përbëjnë esencën dhe thelbin e lëndës së kriminologjisë. Prandaj, njohuritë mbi etiologjinë kriminale kanë rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye, asaj i kushtohet vëmendje dhe kujdes i veçantë. Problemi lidhur me shkaqet burimet dhe rrënjët e kriminalitetit, në etiologjinë kriminale, shpeshherë emërtohen në kuptimin faktor kriminogjenë. Edhe në literaturën kriminologjike dhe etiologjike, shkaqet, burimet dhe rrënjët e kriminalitetit, quhen faktorë kriminogjen. Faktorë kriminogjenë janë të gjitha ato shkaqe, kushte dhe rrethana që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit dhe sjelljeve të ndryshme kriminale në një shoqëri. Çështja e përcaktimit dhe caktimit të kuptimit të faktorëve kriminogjenë në kriminologji, përherë ka zgjuar debate dhe polemika. Fakte kriminogjene konsiderohen të gjitha rrethanat që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit. Faktorët kriminogjen cilësohen si rrethana të natyrës objektive dhe subjektive, që shpjegojnë lidhjet dhe ndikimet me aktivitetet kriminale.⁶³ Në vazhdim do t'i elaborojmë faktorët objektiv dhe subjektiv, do të shpjegojmë cka në të vërtetë paraqesin këto faktorë, në çfarë mënyre ndikojnë në kriminalitet për të cilat parashihet dënim me gjobë si dhe kush bën pjesë në këtë grup faktorësh.

1.2.1.Faktorët objektiv

Sipas mendimit të disa kriminologëve, ndikim më të madh në paraqitjen e kriminalitetit e kanë faktorët e jashtëm kriminogjenë. Sipas tyre, faktorët e jashtëm ose egzogjen, paraqesin kushtet

⁶² Halili Ragip, KRIMINOLOGJIA, Prishtinë, 2008, fq.235

⁶³ Po aty, fq.236

dhe rrethanat determinuese të sjelljes kriminale. Ata ndikojnë drejtpërdrejtë në paraqitjen e aktiviteteve kriminale në shoqëri. Faktorët e jashtëm ose objektiv janë të shumtë dhe secili ka rëndësinë dhe rolin e vetë në paraqitjen e sjelljeve kriminale⁶⁴.

Në këtë punim do të përmendi vetëm disa nga këto faktorë objektiv apo egzogjen, që konsideroj se janë si më të rëndësishëm që ndikojnë në kryerjen e veprave penale për të cilat parashihet dënim me gjobë siç janë:

1.Varfëria, 2. Filmi,3. Alkoolizmi dhe 4. Shkollimi

Varfëria dhe mardhënia me kriminalitetin disa kriminologë ende e quajnë edhe mardhënie të nivelit të ulët të statusit social dhe kriminalitetit. Sido që të quhet kjo mardhënie, i njëjti i ka ndarë mendimet kriminologjike, nga ku, disa varfërinë e rangojnë si kryesore, arsye primare për sjellje delikvente, ndërsa të tjerët nuk i japin rëndësi ndikuese kriminogjene, respektivisht efekti i saj është i kufizuar (Burt, Healy). Edhe përkaj mendimeve të këtyra të kundërta për ndikimin e varfërisë ndaj kriminalitetit, hulumtimet dhe statistikatat tregojnë se kushtet materiale në të cilat jetojnë njerezit paraqesin gjeneratorin e sjelljeve kriminale, veçanërisht në sferën e kriminalitetit kundër pasurisë. Nëse kihet parasysh se gati së në të gjitha shtetet kriminaliteti kundër pasurisë dominon ndaj llojeve tjera të kriminalitetit, kushtet materiale për jetesë nuk mundemi dhe nuk guxojmë ti eliminojmë si faktorë serioz të kriminalitetit.⁶⁵ Duke e ditur se vendi jonë është një ndër vendet me ekonomi më të dobët në rajon dhe varfëria është e dukshme, sjelljet kriminale janë bërë pothuajse normale në vendin tonë. Nga shkak i varfërisë në territorin e gjykatës themelore të Tetovës si vepra për të cilat parashihet dënim me gjobë paraqiten vjedhjet. Kjo nga shkak se nuk kanë kushte elementare për jetesë dhe janë të detyruar që në këtë formë të ushqejnë familjet e tyre. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se çdokush që është i varfër është edhe kriminel, nga shkak se ka shumë familje të varfëra por janë shumë të rrespektuara në rrethin ku jetojnë, por nga praktika dhe analizat tregojnë që familjet e varfëra kanë potencial më të madh për të kryer vepra penale nga shkak i pamundësive ekonomike.

Filmi, si formë e shprehjes artistike dhe si mjet i komunikimit masovik kulturor, gjithashtu ka ndikim të ngjashëm si edhe literatura, televizioni apo mjetet tjera të komunikimit masovik. Mirëpo, filmi, për shkak të paraqitjes të ngjarjes në mënyrë vizuale dhe të gjallë, te shikuesit arrin disa efekte dhe ndikime më të fuqishme dhe më të dukshme. Veçmas kjo manifestohet te shikuesit e rinj, te gjenerata e re. Filmat me përmbajtje joadekuate, ku dominon dhuna, grabitjet epshi dhe instiktet e ulëta, kanë një ndikim negativ te të rinjtë. Këto përmbajtje shpeshherë mund të nxisin veprime kriminale, për arsye se gjeneratat e reja, të rinjtë, nuk kanë aftësi që në mënyrë kritike dhe objektive t'i analizojnë veprimet, rolet dhe ngjarjet e ndryshme të cilat luhen dhe paraqiten në film. Në praktikën gjyqësore përmenden raste të disa sjelljeve dhe veprimeve

⁶⁴По аty, fq.241

⁶⁵ Крстаноски Миладин; КРИМИНАЛИТЕТ И ДЕТЕКЦИЈА, Охрид, 2010, стр.84

kriminale, sidomos të dhunës, plaçkitjes, vjedhjeve, delikteve seksuale por edhe të vrasjeve, të cilat janë bërë me mjete, metoda dhe teknika të ngjashme dhe identike me ato të filmave të ekranizuar.⁶⁶ Filmi siç u spjegua, më shume ndikon tek të rinjtë, duke imituar aktorët e ndryshëm nëpër filma, mundohen që ti zbatojnë edhe në praktikë, dhe në këtë mënyrë hasin me probleme dhe kryejnë vepra të ndryshme penale. Në Republikën e Maqedonisë filmi kë perfshire një mase të madhe të popullatës, sidomos serialet e ndryshme që janë në një numër shumë të madh dhe gati se çdo program televiziv transmeton nga një ose dy seriale të ndryshme në ditë, saqë njerezit kane filluar të flasin edhe me gjuhën e tyre, ndersa me gjestet e tyre shpesh të rinjtë ndeshen me ligjin.

Alkooli Nga faktorët, ose mjetet e varësive, alkooli dhe mënyra e përdorimit të tij në mënyrë të pazakontë dhe jo të plotë ka lidhje të ngushtë me kriminalitetin, veçanërisht me kriminalitetin e dhunës i cili rezulton me lëndime të rënda trupore, dhe shpesh edhe me pasoja për vdekje. Pjesëmarrja e saj veçanërisht është e rëndësishme edhe në lidhjen shkak pasojë në deliktet në komunikacion, ndonjëherë si faktor vendimtar, ndërsa ndonjëherë edhe bashkë me faktorët tjerë. Në teoritë kriminologjike hasim në dy kuptime për alkoolin dhe kriminalitetin. E para, kriminaliteti i alkoolit dhe e dyta, alkoolizëm kriminal me çka te kriminaliteti i alkoolit, alkooli është arsye dhe faktorë për vepra të dënueshme, ndërsa te alkoolizmi kriminal alkooli paraqitet si faktor plotësues, më parë janë marrë me kriminalitet, ndërsa alkooli aktivitet mbështetës.⁶⁷ Alkoolizmi si faktor socio- patologjik, sa i përket dënimit me gjobë është një ndër faktorët kur shqiptohet dënimi me gjobë, në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës e posaçërisht për veprat e penale kundër sigurisë në komunikacionin publik, ku shoferët në gjendje të dehur shkaktojnë aksidente, shpeshherë edhe me pasoja fatale për jetën.

Shkollimi dhe ambienti shkollor. Në literaturën kriminologjike, shpeshherë si faktorë kriminogjenë përmenden edhe rrethanat e kalimit të fëmijëve dhe të miturve, prej në shkollë në shkollën tjetër. Kjo rrethanë, veçmas konsiderohet si faktor i suksesit të dobët dhe mosadaptimit të të miturve në ambientin e ri shkollor, kur ky kalim është bërë pa dëshirën dhe vullnetin e fëmijëve dhe të miturve. Një kalim i këtillë lë gjurmë të rënda në psikën e fëmijëve dhe të miturve. Këta fëmijë dhe të mitur, me vështirësi të mëdha janë pajtuar me faktin se tani gjenden në një ambient të ri shkollor. Ata, nuk adaptohen për një kohë të gjatë dhe rëndom, e ndjejnë veten të vetmuar e nga ana tjetër shpeshherë hasin edhe në një pritje të ftohtë, e në disa raste edhe “armiqsore” të nxënësve dhe të miturve në ambientin e ri. Kështu, të rinjtë dhe të miturit, për të kapërcyer këtë gjendje, jepen pas ikjes nga shkolla, pas shoqërimit me fëmijë dhe të mitur problematik dhe, më në fund, edhe pas aktiviteteve kriminale. Prandaj, shkolla si institucion, mikrosocial dhe dobësitë e shprehura në procesin e arsimimit dhe edukimit, mund të ndikojnë në paraqitjen e disa sjelljeve kriminale dhe dukurive negative në shoqëri. Në këto raste, edhe shkolla mund të trajtohet si faktor kriminogjen, i cili i kontribuon paraqitjes së disa formave të

⁶⁶ Halili Ragip, KRIMINOLOGJIA, Prishtinë, 2008, fq.267

⁶⁷ Крстаноски Миладин; КРИМИНАЛИТЕТ И ДЕТЕКЦИЈА, Охрид, 2010, стр.103

kriminalitetit në rradhën e të miturve dhe të rinjëve.⁶⁸ Poashtu edhe për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetoves, ndikim të madh në sjelljet kriminale ka ky lloj faktori, posaçërisht për vjedhjet e imëta që i kryejnë te miturit ose të rinjtë duke u ndikuar nga faktorët që u përmenden më lartë.

1.2.2. Faktorët e brendshëm (subjektiv)

Sado që faktorët e jashtëm apo objektiv u takon një rol me rëndësi në paraqitjen e sjelljeve kriminale, dukuria e kriminalitetit dhe shkaqet e saj, nuk mund të shpjegohen drejt dhe deri në fund pa analizën dhe ndriçimin e faktorëve të brendshëm, subjektiv, të cilët kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit. Kur flitet për faktorët subjektiv, zakonisht mendohet për individin, për personalitetin e njeriut, në rastin konkret, të njeriut delikuent. Në këtë drejtim, posaçërisht theksohet roli dhe rëndësia e jetës së tij biopsikike dhe lidhjet e saj me sjelljet dhe veprimet kriminale. Në literaturën kriminologjike ekziston një bindje e arsyeshme dhe bukur e përhapur se vetitë biologjike dhe psikike shumë herë janë komponente me rëndësi vendimtare në jetën e njeriut. Varësisht se si janë zhvilluar dhe si funksionojnë, ato kanë ndikim në sjelljet dhe në qëndrimet e njerëzve. Thuhet se ndikimet e faktorëve të jashtëm në sjelljet dhe veprimet e personalitetit varen shumë edhe nga vetë struktura e biologjisë dhe psikikë e atij individi. Nëse ajo strukturë është normale, nëse është zhvilluar në mënyrë harmonike, nëse ka defekte dhe anomali, atëherë personaliteti i njeriut është më rezistent ndaj ngacmimeve dhe ndikimeve që vijnë nga jashtë, nga veprimi i kushteve dhe faktorëve subjektiv.⁶⁹

Në vazhdim do të shqyrtoj disa nga këto veti të cilat konsiderohen si më kryesore në personalitetin e një individi për kryerjen e veprave penale për të cilat shqiptohet dënim me gjobë si dënim kryesor siç janë:

Karakter, Temperamenti, Shprehitë dhe prirjet.

Karakter është një ndër vetitë kryesore të personalitetit të njeriut. Karakteri konsiderohet si cilësi esenciale e një personaliteti. Në literaturën psikologjike, shpeshherë, kuptimi ose nocioni karakter indentifikohet me nocionin personalitet. Kësisoj, në të folurit e përditshëm, dëgjohej të thuhet për një njeri se ai është “ karakter i fortë” ose “ karakter i dobët”, apo “ai është personalitet i fuqishëm” apo “personalitet stabil” ose “i dobët”, “labil” etj. Mirëpo, kuptimi ose nocioni karakter, këtu paraqet vetëm një veti psikike të një individi të një personi, e jo individin komplet apo personalitetin e tij. Megjithatë, kur flitet për karakterin, zakonisht mendohet për vetitë më të qëndrueshme të individit apo për cilësitë të cilat vulojnë tërë aktivitetin njerëzor të tij. Kështu, si komponenta të karakterit, në literaturën psikologjike dhe kriminologjike

⁶⁸ Halili Ragip, KRIMINOLOGJIA, Prishtinë, 2008, fq.285

⁶⁹ Po aty, fq.339

konsiderohen: vullneti, qendrueshmeria, vendosmëria, konsekuenca, iniciativa, guximi, besnikëria, atlurizmi, stabiliteti, siguria etj.

Të gjitha këto dhe vetitë tjera, janë të rëndësishme në shpjegimin e shumë sjelljeve delikuate. Është e domosdoshme që gjatë ndriçimit të çdo sjelljeje kriminale të individit, të njihet edhe karakteri i personalitetit të atij individ. Njohja e tipareve dhe vetive të karakterit të kryerësit të krimit apo sjelljes tjetër delikuate, ndihmon në ndriçimin e shkaqeve të sjelljes kriminale. Dhe, njëherit, kjo është me rëndësi edhe për procesin e rehabilitimit dhe risocializimit të personit të dënuar sepse, pa njohjen e vetive që kanë të bëjnë me rezultate më të mira në pengimin e kriminalitetit në një shoqëri.⁷⁰ Pra, siç shihet karakteri është faktor i rëndësishëm për shpjegimin e sjelljeve kriminale, gjithashtu edhe për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë.

Shprehitë dhe prirjet Gjatë zhvillimit të tij, personaliteti, në bazë të veprimeve endogjene dhe egzogjene, arrin në shprehje dhe prirje të caktuara pozitive ose negative si gjendje e mënyrës së tij të jetesës. Në qoftë se veprimet e këtilla krijojnë personalitet kriminogjen, bëhet fjalë për delikuent sipas prirjeve, përkatësisht delikuent sipas shprehive, për të cilin kryerja e veprimeve të kundërligjshme është mënyrë dhe “stil” i jetesës. I pandarë është mendimi që sa më e afërt të jetë lidhja në mes delikuentit dhe veprës së tij, aq më e madhe është rrezikshmëria shoqërore, e cila rrezikshmëri ka anën objektive, por para se gjithash anën subjektive (mardhënia e kryerësit ndaj veprës). Bëhet fjalë për ekzistimin e lidhjes në mes veprimit të inkriminuar dhe vetitë e personalitetit të delikuentëve të tillë. Prirja është veçuri psikologjike e veçantë e njeriut e krijuar nën ndikimin e rrethit shoqërorë, e cila krijohet, ndryshohet, transformohet me zhvillimin e personalitetit. Prirjet dhe shprehitë të njeriut mund të jenë pozitive ose negative, varësisht nga ajo se nga cilat forca të ndikimit njeriu është zhvilluar dhe a kanë ndikuar ndaj tij forcat negative ose pozitive të shoqërisë. Personat të cilët janë të futur më thellë në shprehje antisociale jo rallë përcaktohen për aktivitet kriminal të cilët kriminologjia i quan “delikuent sipas shprehisë“, si kategori e veçantë e kriminelëve të shprehur veçanërisht në kriminalitetin e dhunës dhe profesional.⁷¹

Temperamenti është gjithashtu një faktor i brendshëm i cili ndikon për sjellejet kriminale kur shqiptohet dënimi me gjobë. Temperamenti është një veti dhe cilësi me rëndësi psikike për individin, e cila ka të bëjë me ragimin e tij ndaj ngacmimeve dhe nxitjeve të ndryshme, të jashtme. Disa autorë theksojnë se temperamenti është një veti psikike e personalitetit e cila ka të bëjë me reagimet e tij emocionale, sidomos me intensitetin e reagimeve të tilla. Të tjerët mendojnë se temperamenti duhet të cilësohet si reagim komplet psikik i njeriut, e jo vetëm një reagim emocional. Gati pjesa dërmuese angazhohen që si kuptim të temperamentit duhet marrë tërë aktivitetin psikomotorik të individit. Temperamenti nuk paraqet vetëm mënyrat e reagimit psikik, ai nënkupton shpejtësinë dhe zgjatjen e reaksioneve të individit ndaj ngjarjeve dhe ngacmimeve, të ambientit i cili e rrethon. Për këtë arsye, disa autorë, me të drejtë, me nocionin

⁷⁰ По ату, fq.340

⁷¹ Крстаноски Миладин; КРИМИНАЛИТЕТ И ДЕТЕКЦИЈА, Охрид, 2010, стр.125

“temperament” nënkuptojnë mobilizimin e energjisë që disponon individi në drejtim të caktuar. Në literaturën e psikologjisë së personalitetit dhe psikologjisë së përgjithshme, përmenden disa klasifikime apo ndarje të tipave të ndryshëm të temperamentit. Kësisoj janë të njohura klasifikimet e Hipokratit, Pavlovit, Sheldonit, Krecmerit dhe të tjerëve. Klasifikimi më i njohur dhe më i vjetër i tipave të temperamentit, është ai i filozofit dhe mendimtarit të njohur grek, Hipokratit. Sipas tij njerëzit ndahen në katër tipe të temperamentit: kolerik, sanguinik, flagmatik dhe melankolik.⁷² Nga gjithë çka u tha më sipër, mund të konstatojmë se ekzistojnë faktorë të shumtë që ndikojnë në sjelljet kriminale kur shqiptohet dënimi me gjobë. Faktorët e lartëpërmendur janë disa nga faktorët më të shpeshtë që ndikojnë në kryerjen e veprave penale për të cilat shqiptohet dënim me gjobë. Mirëpo kjo nuk do të thotë se edhe faktorët e tjerë nuk janë të rëndësishëm për sjelljet kriminale për të cilat parashihet dënim me gjobë, por këto i përmendëm si më kryesorët.

1.3. Ekzekutimi i dënimit me gjobë në Territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga viti 2007-2012

Në këtë pjesë do të flas për ekzekutimin e dënimit me gjobë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës përgjatë periudhës nga viti 2007-2012, ku do të paraqes numrin e dënimeve që janë shqiptuar dhe ekzekutuar në këtë periudhë kohore duke u bazuar në të dhënat e regjistrave penal të Gjykatës Themelore si dhe statistikave të Entit Shtetërorë për statistikë. Sipas të dhënave statistikore nga regjistri penal i Gjykatës Themelore të Tetovës, në vitin 2007 në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës janë shqiptuar gjithësej 306 dënime me gjobë si dënime kryesore, ndër to shumica e veprave penale për të cilat është shqiptuar dënimi me gjobë janë për veprat penale kundër sigurisë në komunikacion, konkretisht vepra penale rrezikimi i sigurisë në trafik, ndërsa pas kësaj veprë pasojnë veprat penale kundër pasurisë, konkretisht vepra penale e vjedhjes dhe vepra penale e mashtrimit. Ndërsa në vitin 2008 janë shqiptuar gjithësej 389 dënime me gjobë, nga të cilat gjithashtu dominojnë veprat penale kundër sigurisë në komunikacion, dhe kundër pasurisë ndërsa vërehet edhe vepra penale kundër rendit publik për të cilën janë shqiptuar një numër i konsiderueshëm i dënimeve me gjobë si dënim kryesor, bëhet fjalë për veprën penale heqja ose dëmtimi i vulës apo shenjës zyrtare. Në këtë vit poashtu vërehet se ka rritje të dënimit me gjobë në krahasim me vitin 2007, për 83 dënime me shumë. Në vitin 2009 kemi numër pothuajse të njëjtë me vitin 2008 ku janë shqiptuar 398 dënime me gjobë si dënim kryesorë për vetëm 9 dënime më shumë.⁷³ Ndërsa gjatë viti 2010 janë shqiptuar gjithësej 424 dënime me gjobë si dënim kryesorë, me cka vërejmë një rritje të dukshme të numrit të gjobave të shqiptuara nga vitet kaluara. Këto statistika janë të bazuara sipas regjistratit penal të Gjykatës Themelore të Tetovës. Ndërsa në vazhdim do të paraqes statistikën për vitin 2011 dhe 2012 në bazë të të dhënave të Entit Shtetërorë për statistikë. Sipas të dhënave nga Entit Shtetërorë për

⁷² Halili Ragip, KRIMINOLOGJIA, Prishtinë, 2008, fq.342

⁷³ Të dhëna statistikore nga Gjykata Themelore e Tetovës

statistikë gjatë vitit 2011 gjithësej janë shqiptuar 226 dënime me gjobë si dënim kryesor, me çka shihet se ka rrënie të madhe të numrit të gjobave të shqiptuara në krahasim me vitin 2010. Ndërsa në vitin 2012 numri i dënimeve të shqiptuara me gjobë arrin në 415 si dënim kryesor që është dukshëm më i madh nga viti praparak.⁷⁴

Në vazhdim do të paraqes në mënyrë tabelare numrin e gjobave të shqiptuara në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga viti 2007-2012.

Tabela nr.4 Dënimet e shqiptuara me gjobë si dënim kryesor në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës nga periudha 2007 - 2012

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Gjithësej
Dënime të shqiptuara me gjobë	306	389	398	424	226	415	2158



Në vazhdim do të paraqes një rast të shqitpimit të dënimit me gjobë në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës për veprën penale të mashtrimit e cila parashihet në nenin 247 paragrafi 1 të Kodit penal.

⁷⁴ www.stat.gov.mk Enti Shtetërorë për Statistikë i Republikës së Maqedonisë

Rasti nr.2

Aktgjykimi nr. K-794/1 i dates 04.01.2013

Kryerësi shpallet fajtor, për arsye se:

Në gjysmën e dytë të muajit Gusht 2012, në Tetovë me qëllim që për vete të përfitojë dobi pasurore të kundërligjshme e ka mashtruar të dëmtuarin me inicale N.F nga Tetova, me shfaqje të rrejshme të fakteve në atë mënyrë që rrejshëm i është prezantuar si i punësuar në EVN Maqedoni filialla Tetovë, për të cilën i dëmtuari i ka besuar, dhe në të njejtën kohë në shtëpinë e tij me lokacion në lagjen Drenovc me nr.1, i ka vendosur matës të rrymës elektrik me numër 47507-328 dhe i ka dhënë kontratë për furnizim me rrymë elektrike sikur të jetë lidhur në mes EVN Maqedoni dhe të dëmtuarit duke e çuar në dëm të pasurisë së tij, I ka paguar 529 euro në kundërvlerë prej 31.800 denarë.

Dhe në këtë mënyrë i akuzuari ka kryer veprën penale MASHTRIM sipas nenit 247 paragrafi.1 të Kodit penal.

Për këtë gjykata e DËNON:

me dënim me të holla prej 100 gjoba në lartësi të një gjobe ditore prej 10 euro ose gjithësej 1000 – NJËMIJË EURO në kundërvlerë të denarit prej 61.51 denarë, të cilën duhet ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, ndërsa në rast të mospagesës e njejtta do të shndërohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo gjobë ditore nga një ditë burgim por jo më shumë se 6 muaj.

TË PAGUAJ:

në emër të paushallit penal në dobi të mjeteve buxhetore gjykatës t'i paguaj një shumë prej 2.000 denarë në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

OBLIGOHET:

I akuzuari me inicale I.B nga Tertova që të demtuarit me inicale N.F nga Tetova t'ia kompensojë dëmin me vlerë prej 529 Euro në kundërvlerë prej 31.800 denarë, në afat prej 30 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në këtë rast shohim fajtor shpallet personi i cili ka kryer veprën penale MASHTRIM nga neni 247 paragrafi.1 i Kodit Penal, dhe fajtorit i shqiptohet dënim me të holla prej 100 gjoba ditore prej 10 Euro, ose gjithësej 1000- NJËMIJE EURO në kundërvlerë të denarit dhe gjithashtu fajtori obligohet që të kompensojë dëmin e shkaktuar. Duke pat parasysh se në Kodin penal parashihet dënim me gjobë dhe dënim deri në 3 vjet burgim, mendoj se dënimi i shqiptuar është i butë në krahasim me dëmin që e ka shkaktuar.

Ky është një rast që verteton atë që tham më larte se veprat penale kundër pasurisë sipas të dhënave statistikore të nxjera nga Gjykata Themelore e Tetovës janë kryesisht vepra penale të vjedhjes dhe të mashtrimit. Ky rast që e spjeguar është një rast tipik i veprës penale të mashtrimit dhe veprës penale kundër pasurisë që ndodhin më së shpeshti kur shqiptohet dënimi me gjobë.

Kapitulli i pestë

1.Parandalimi dhe luftimi i veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë

Me parandalimin e kriminalitetit në praktikën e politikës kriminale bashkëkohore, merren shumë organe shtetërore, shoqëri dhe institucione, si forca të posaçme preventive, të cilat konsiderohen si bartës të kësaj veprimtarie. Në procesin e luftimit preventiv të kriminalitetit është me rëndësi të madhe të përcaktohen prerazi dhe konkretisht rolet, detyrat dhe qëllimet e subjekteve të caktuara të aktivitetit parandalues. Sistemi i prevencionit shoqëror duhet të ketë mbështetje shkencore dhe duhet të fillojë nga analizat shkencore dhe nga përpunimi i masave për sëndërtimin e determinatave sociale të dukurive antishoqërore e sidomos sjelljeve të inkriminuara.⁷⁵ Dënimi me gjobë është një mjet efikas në luftën kundër kriminalitetit, sidomos kur është çështja për veprat penale që janë kryer me qëllim përfitimi. Përveç kësaj, përparësi themelore e dënimit me gjobë është se ai është sanksion penal i përshtatshëm për veprat penale të natyrës së lehtë, ku dënimet me heqje të lirisë me afat të shkurtër kishin për të qenë jo-efikase⁷⁶ Në shuarjen dhe parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi, dhe kriminalitetit kundër pasurisë në veçanti i cili mbizotëron në strukturën e kriminalitetit modern, të gjitha legjislaturat penale modern parashohin sistem të ndryshëm të sanksioneve penale. Ndër to për nga natyra, karakteri, veprimi dhe rëndësia veçojnë dënimet penale pasurore. Duke e pasur parasysh karakterin specifik të veprave penale pasurore dhe personalitetin e kryerësve të tyre është paraparë dënim pasuror specifik- dënim me gjobë i cili përkrah efektit represiv ka edhe efektin preventiv.⁷⁷ Në këtë punim do të spjegojmë disa nga organet dhe institucionet më të rëndësishme që ndikojnë në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, konkretisht për luftimin e veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë. Do të flasim për rolin dhe kontributin që japin këto organe dhe institucione për parandalimin e sjelljeve kriminale duke filluar nga masat preventive dhe duke vazhduar me masat represive që këto organe shtetërore dhe institucione marrin.

1.1.Masat preventive

Zhvillimi i dimensionit social preventiv në kuadër të luftës kundër kriminalitetit është kushtëzuar nga rrethanat sikurse që është thënë se lufta penale juridike nuk mund të jetë formë e kënaqëshme në këtë proces. Kjo formë e luftës është e domosdoshme, mirëpo, shoqëria nuk duhet të kufizohet vetëm në të, po që se dëshiron të lirohet më radikalisht dhe më me sukses nga kriminaliteti dhe delikuenca. Për këtë na bind historia e kaluar e luftës kundër kriminalitetit të cilën shumë autorë përparimtarë e shfrytëzojnë për përhapjen e mendimeve dhe të qëndrimeve

⁷⁵ Latifi, Vesel, POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë, 2011, fq.179

⁷⁶ Sërzentiq Nikolla- Stajiq Aleksandër; E DREJTA PENALE, Prishtinë,fq,217

⁷⁷ Јовашевич, Драган и Пертовиќ Драган, ЗБОРНИК НА ТРУДОВИ НА ПРАВНИОТ ФАКУЛТЕТ „ЈУСТИНИАН ПРВИ“ Посветен на проф.др.Фрањо Бачич, Новшана казна у новом кривичном праву Републике Србије, Скопје, 2007, стр.518

bashkëkohore. Mosefikasiteti në luftimin e kriminalitetit, në një pjesë të madhe e ka shkakun e vet në faktin se kjo e vërtetë ende nuk po kuptohet sa duhet. Për këtë arsye mendimi politik kriminal, kohëve të fundit orientohet gjithnjë e më tepër në funksion të risocializimit preventiv social për delikuentët duke konsideruar se mu këtu qëndron thelbi i zgjidhjes së kësaj dukurie shoqërore. Këtu është fjala për krijimin dhe zhvillimin e kushteve të atilla shoqërore, të cilat e eliminojnë gjithnjë e më tepër munësinë e socializimit negative të personalitetit e me këtë edhe kufizohen sjelljet e rrezikshme shoqërore brenda një vëllimi më të vogël dhe një rrethi më të ngushtë, të cilët shoqëria sipas parashikimeve tona, do të mund t'i përballojë më lehtë, pa dhembje dhe më me sukses në kushtet e atilla të zhvilluara se sa në kohën tonë, e cila është përplot, shkatërime, devijime e humnera.⁷⁸ Për parandalimin e veprave penale për të cilat shqiptohet dënim me gjobë, do të përmendim faktorët si më kryesorë për parandalimin e sjelljeve kriminale, duke filluar nga Arsimimi dhe edukimi, roli i mediave të shkruara dhe elektronike, roli i organizatave joqeveritare, si dhe roli i familjes.

1.1.1.Arsimimi dhe edukimi

Shkolla trajtohet si një institucion që ka forcë të madhe ndikuese, jo vetëm në aspektin e edukimit dhe të ngritjes kulturore, por edhe në aspektin e zhvillimit emocional dhe intelektual në formimin e tërësishëm të strukture së personalitetit të njeriut. Në këtë aspekt, ajo ka përparësi të jashtëzakonshme dhe mundësi të pakufizuar, sepse ka kontakte me pjesën më të madhe të rinisë, që nga rinia e hershme e deri në moshën e pjekurisë. Pasi fëmijët qëndrojnë për një kohë të gjatë në shkollë, arsimtarët kanë rast t'i vërejnë pa vështirësi simptomat e papërshtatshmërisë, kurse në raste të veçanta edhe mund të përcaktojnë parashikimin e trajtimit individual të tyre që i shfaqin karakteristikat e papërshtatshmërisë në sjelljet e veta. Për këtë arsye, shkolla është në gjendje t'i korigjojë devijimet psikike e të tjera të rinjve të caktuar dhe t'i orientojë drejt. Përvoja jonë tregon se në procesin e sëndertimit të qëllimeve edukative dhe të formimit të njerëzve të rinj duhet kushtuar kujdes të posaçëm të sjelljeve të nxënësve, sepse ata në këtë mënyrë orientohen drejt dhe përgatiten për pjesëmarrjen e mëvonshme më të gjërë dhe më aktive në jetën shoqërore. Me këto procese edukative, të ndërlidhura me jetën, shkolla mund t'i eliminojë dukuritë negative në sjelljet e rinisë, mosinteresimin, dhënien pas bredhjeve, vjedhjet e imëta, ikjen nga shkolla, e të tjera të ngjashme. Si institucion i posaçëm edukativ shkolla mund të luaj rol të rëndësishëm duke u dhënë ndihma prindërve në edukim kurse institucioneve të specializuara në trajtimin e individëve dhe në orientimin e tyre me rastin e zgjedhjes së llojit të mëtejme të shkollimit. Roli i saj mund të jetë poashtu i rëndësishëm në aspektin e përgatitjes së programit për shfrytëzimin e kohës së lirë dhe zhvillimin e bashkëpunimit me organet e ndryshme lokale, me institucionet shoqërore dhe të specializuara, me linjën e zhvillimit të prevencionit kundër delikuençës së rinjve.⁷⁹ Shkolla si institucion edukativo – arsimor, pra luan një rol të rëndësishëm në

⁷⁸ Latifi, Vesel; POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë. 2011, fq.179

⁷⁹ Po aty, fq.198

parandalimin e veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë, pasiqë edukatorët, gjegjësisht mësuesit dhe profesorët në instituiconet arsimore kanë një ndikim të madh të nxënësit për ti edukuar dhe për ti larguar nga sjelljet devijante me anë të programeve arsimore të cilat zbatohen në këto institucione arsimore. Pra, shkollat janë ata të cilat kanë një rol të veçantë në reduktimin e numrit të sjelljeve kriminale, për të cilat shqiptohet dënim me gjobë.

1.1.2.Roli i mediave të shkruara dhe elektronike

Në drejtim të aktivizimit shoqëror për luftë kundër kriminalitetit dhe të zhvillimit shoqëror antikriminal, rol të posaçëm i përket informimit të drejtë të qytetarëve në lidhje me dukuritë e sjelljes delikuede dhe kriminale në një mjedis të caktuar. Një informim i tillë mëse i domosdoshëm në një shoqëri, në të cilën vetë qytetarët bëjnë përpjekje në drejtim të njohjes së problemeve të shoqërisë. Interesimi i tyre për zgjidhjen e këtyre problemeve është aq më i madh sa më shumë të jenë të informuar në mënyrë të përafërt dhe të saktë. Me të drejtë mund të thuhet se njohja dhe informimi janë kushte të domosdoshme për aftësimin e qytetarëve, të organeve shtetërore dhe të institucioneve për kryerjen e punëve të tyre shoqërore. Arritja e sukseseve të tilla në aspektin e informimit të qytetarëve në lidhje me këto dukuri bëhet në mënyra të ndryshme, ndër të cilat më të rëndësishme janë mjetet e informimit publik (shtypi, radioja, televizioni, filmi etj.). Mjetet e komunikimit masiv në botën bashkëkohore, janë bërë mjete të fuqishme të ndikimit dhe orientimit të opinionit brenda një vendi apo opinionit ndërkombëtar. Roli i tyre është aq më i madh nga shkaku se ato paraqesin njëkohësisht faktorë të fuqishëm për ndikimin e organizuar edukativ, fuqia e të cilit rritet nga dita në ditë dhe gati nuk ngec prapa nga ndikimi i familjes dhe i shkolles si faktor “klasik“ edukativ. Për organizimin e aksioneve shoqërore kundër kriminalitetit është më se e nevojshme njohja e karakteristikave të tyre etiologjike, fenomenologjike dhe karakteristika e tjera në mjedisin e caktuar. Çdo aksion supozon një njohuri të caktuar për lëndën e vet e cila shërben si orientim udhëheqës dhe praktik, nëse dëshirohet të shmangen proceset stihike dhe pasojat e tyre. Që të mund të ndërmerret aksioni efikas shoqërorë, është e domosdoshme depërtimi njohës për karakterin rrënjes, shkakut dhe kushteve të kriminalitetit me suazat e dhëna kohore dhe hapësirë.⁸⁰ Pra roli i mediave të shkruara dhe elektronike është shumë domethënës në parandalimin e sjelljeve kriminale, për veprat penale për të cilat shqiptohet dënim me gjobë, mediat e shkruara dhe elektronike kanë mundësinë dhe fuqinë të ndikojnë dukshëm në minimizim të veprave penale për të cilat shqiptohet dënim me gjobë, pasiqë me njoftime dhe lajme të ndryshme ato janë shumë më afër qytetarit i cili mund të informohet në çdo kohë. Mendoj se në vendin tonë, roli i mediave të shkruara dhe elektronike nuk janë në nivelin e duhur për të ndikuar në parandalimin e kriminalitetit nga shkaku se më shumë rëndësi u kushtojnë programeve që nuk kanë asnjë ndikim pozitiv tek shikuesit. Përkundrazi më shumë rëndësi u japin programeve që ndikojnë negativisht tek shikuesit, sidomos tek shikuesit apo ndjekësit e rinjtë.

⁸⁰ Po aty, fq.225

1.1.3.Organizatat joqeveritare

Organizat joqeveritare janë organizima të financuara dhe të mbështetura nga faktorë të ndryshëm joqeveritar e që janë të paramenduara të krijohen për të zgjidhur një problem shoqëror, individual, grupor ose më të gjerë; për të marrë pjesë në jetën publike; për të shfrytëzuar burimet për arritjen e një qëllimi të caktuar. Varësisht nga financimi dhe veprimtaria e tyre ato mbështete apo edhe ndalohen nga qeverit shtetore në teritorit e të cilës ato veprojnë.

Në lidhje me karakteristikat e organizatave joqeveritare, mendohet se dominojnë këta përcaktorë: se ato janë formalisht të institucionalizuara; se janë joqeveritare që shumëkush “i quan private”; se janë jo te përfitueshme; vullnetare dhe, natyrisht, vetëqeverisëse. Ndërsa, sa i përket funksionit të tyre, ai shtrihet në: “shoqërimin e qytetarëve; në-shoqërimin politik të qytetarëve-politizimi; në mbledhjen e informacioneve; në arsimimin e njerëzve për fusha të caktuara; në përfaqësim dhe në shtrirjen e ndikimit dhe të mbikëqyrjes. Kështu p.sh organizata joqeveritare me seli në një shtetë tjetër zakonisht paraqiten në shtetin tjetër si organizata joqeveritare ndërkombëtare, mirëpo veprimtaria e tyre në shtetin tjetër varret në shkallë të madhe nga mardhënjet ndërkombëtare të atyre shteteve. Raste të ndalimit apo të mos lejimit të hyrjes në shtetin e vet për shkak të mbështetjeve indirekte qeveritare.”⁸¹

Sipas ligjit për shoqatë dhe fondacion, organizatat mund të fitojnë status me karakter publik nëse kryejnë veprimtari me karakter të interes publik, zbatojnë programe dhe projekte në nivel qëndrorë ose lokal, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me drejtorinë shtetërore dhe organet e komunave, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit, si dhe shfrytëzimin e mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve. Veprimtaritë me karakter publik janë: zhvillimi i demokracisë, shoqëritë civile dhe të drejtat e njeriut, - ndihmë dhe mbrojtje të personave me hendikepe fizike dhe psikike, personat me pengesa të zhvillimit dhe socializimin e tyre, mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjtë, mbrojtjen e personave të marginalizuar dhe socializimin e tyre, mbrojtjen nga keqpërdorimi i drogës, sëmundjet ngjitëse seksuale, delikuencën e të miturve, alkoholizmi, prostitucionin dhe tregtinë me njerëz, shëndetësi, zhvillimin në shëndetësi dhe kujdesin mjekësorë, art, kulturë dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore, sporti amator, mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm, zhvillimin lokal dhe infrastrukturor, shkencë, arsim dhe trajnime në procesin arsimor, zhvillimin e etikës dhe moralit, ndihmë humanitare dhe sociale, zbutjen e varfërisë, menaxhimi me fatkeqësitë e papritura, mbrojtja dhe kujdesi i kafshëve, mbrojtjen e konsumatorëve, zhvillimin e bamirësisë dhe vullnetarizmit, dhe aktivitete tjera me karakter publik të percaktuara me këtë ligj.⁸² Me vetë faktin se janë të krijuara për të zgjidhur probleme shoqërore, individuale, grupore ose më gjërë, këto lloj organizatash kanë një rol të rëndësishëm edhe në parandalimin e veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak se me aktivitetet e tyre të ndryshme ndikojnë te njerëzit që të mos vije deri te veprat kriminale.

⁸¹ https://sq.wikipedia.org/wiki/Organizata_joqeveritare

⁸² Neni 73 dhe 74 i Ligjit për shoqata dhe fondacione i Republikës së Maqedonisë

1.1.4.Roli i familjes

Familja është grup themelor i shoqërise që, varësisht prej zhvillimit shoqërorë-ekonomik mbledh rreth vetes njerëz të lidhur me martesë dhe pasardhësit e tyre eventualisht një rreth më të gjërë ose më të ngushtë njerëzish të një gjaku ose me lidhje të tjera, të cilët bashkohen me qëllim që t'i kënaqin nevojat e veta të ndryshme biologjike, (lindjen dhe rritjen e fëmijëve) ekonomike, sociale, edukative, emotive etj. Familja, si bashkësi shoqërore, paraqet faktorin më me rëndësi në zhvillimin dhe formimin e personalitetit të njeriut. Familja, si institucion i veçantë shoqërorë, përherë ka pasur dhe tani ka funksione dhe detyra të shumëfishta në formimin, edukimin, ngritjen, zhvillimin dhe afirmimin e anëtarëve të vet, e sidomos fëmijëve dhe të rinjve. Ajo paraqitet si bashkësi shoqërore, njësi shoqërore, si grup parësor shoqëror, me të cilin njeriu, prej lindjes e deri në vdekje, gjendet dhe qëndron, duke pasur kujdesin dhe mbykëqyrjen e anëtarëve të vet. Familja është bashkësi shoqërore, e cila mbron dhe orienton anëtarin e vet, sidomos fëmijët dhe të rinjtë. Është e ditur se familja paraqet fuqinë më të rëndësishme shoqërore për edukimin e drejtë dhe orientimin jëtesor të të rinjtë. Ajo si instrument më i lartë i kontrollit shoqëror është në gjendje të kujdeset vazhdimisht për fëmijet dhe të rinjtë, të forcoje stabilitetin e tyre psikologjik e të zhillojë tek ata ndjenjën e përgjegjësisë. Kësisoj familja manifestohet njëkohësisht edhe si fuqi e madhe në prevencionin e veprave penale. Ndërkaq, në kushtet bashkëkohore të industrializimit dhe urbanizimit me levizshmëri të madhe shoqërore dhe me proceset e tjera sociale vazhdimisht është duke u transformuar edhe jeta familjare dhe ngecja me rolin e saj në sëndertimin e kontrollit social.⁸³

1.2.Masat represive

Që nga paraqitja e historisë së klasave , reagimi shoqërorë ndaj sjelljeve të inkriminuara është mbështetur në baza penale – juridike, në dënimin dhe ndëshkimin. E vetmja formë e reagimit për një kohë të gjatë ka qenë lufta në frymen e normave dhe të kodekseve penale, që janë zbatuar nga organet e judikaturës penale në mënyrë të ashpër dhe represive. Represioni ka qenë karakteristikë qenësore e cila nuk ka ndryshuar përmbajtësisht deri në ditët tona, ndonëse ka pasur lehtësi të caktuar, sidomos në shekullin e kaluar dhe në fillim të shekullit tonë e të cilat nuk duhet të nënçmohen. Vetëm në shekullin tonë, sidomos në kohën e tanishme, zhvillohet kritika më radikale kundër zgjedhjeve dhe praktikës represive dhe braktisen ngadalë konceptet dhe veprimet represive ndaj kryerësve të veprave penale e kështu fillon edhe aplikimi i prevencionit social në praktikën e politikës kriminale. Kur flasim për represionin dhe përcaktojmë dimensionin e tij historik, kuptohet se duhet ta dallojmë ndëshkimin, i cili bazohet në qëllimet atributive të ngjashme, prej atij të sistemeve penale bashkëkohore, që synon riedukimin dhe riintegrimin si qëllim themelor të tij. Në rastin e parë fjala është për represion në kuptimin e plotë, për represionin si sjellje dominante ndaj personave të dënuar, të cilët duhet dënuar dhe

⁸³ Latifi, Vesel, POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë, 2011, fq.195

izoluar nga shoqëria.⁸⁴ Politika kriminale nuk mund të veprojë e shkëputur nga llojet e tjera të politikave, veçanërisht në ato ekonomike, sociale etj. Mirëpo, politika, kriminale, në zbatimin e saj, mbi të gjitha është e varur nga organet e jurisprudencës penale. Funksionimi i sistemit të drejtësisë penale duhet të sigurojë mbrojtjen edhe të interesave të viktimës. Ç'është e vërteta, politika kriminale duhet të orientohet drejt parandalimit të krimit. Një ndër orientimet e politikës kriminale bashkëkohore është që mjetet dhe metodat e luftës kundër krimit të rrespektojnë parimet demokratike, të shtetit të së drejtës dhe të drejtat e njeriut. Kështu, çdo reformë në legjislacionin penal dhe procedurë penale, në sistemin e drejtësisë penale, në polici dhe në prokurori, të ndërmerret duke mbajtur parasysh parimet e tilla.⁸⁵ Ndër institucionet më të rëndësishme që kanë rol të rëndësishëm në parandalimin e veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë do ti spjegojmë më poshte duke filluar nga: policia, prokuroria, gjykatat dhe në fund institucionet penitenciar.

1.2.1.Policia

Policia (politia.lat.) është organ shtetërorë që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, mbajtjen e rendit dhe të qetësisë publike si dhe sigurimin e rendit të caktuar shtetërorë. Policia është një institucion tradicional i njohur për mbrojtjen e rendit shoqërorë në të gjitha tipet historike shoqërore dhe në të gjitha vendet në bote. Në të gjitha vendet, duke llogaritur edhe shoqëritë bashkëkohore, policia, përveç në aspektin formal, ka të njejtat përcaktime shoqërore dhe përafërsisht kryen të njejtat funksione dhe detyra. Kjo nuk do të thotë se në mesin e policive të vendeve të caktuara të vendeve të ndryshme shoqërore, nuk paraqiten dilema pak a shumë të mëdha, që i përkasin karakterit të tyre shoqëror përnga vëllimi dhe llojet e autorizimeve, për nga karakteri i funksionimit të tyre, përnga pozita shoqërore edhe për nga forma e paraqitjes së policive. Në disa vende të zhvilluara (SHBA, Angli etj) ekzistojnë organizma private të sigurimit (policitë private), që kanë për detyrë të mbrojnë pasurine private sidomos ndërmarrjet komerciale private nga grupet dhe bandat e kriminelëve. Ato themelohen atje ku është i zhvilluar kriminaliteti, sidomos format e organizuara të tij dhe ku policia nuk është e aftë t'u kundërvihet për arsye të ndryshme të formave të tij.⁸⁶ Në Republikën e Maqedonisë këto lloje të policive private që u përmendën, funksionojnë ashtu që bëjnë sigurimin e objekteve afariste, si fabrika apo depo mallrash, me qëllim të mbrojtjes nga vjedhet e ndryshme që mund të ndodhin, por jo me të njejtin qëllim që kanë policitë private në vendet ku është i zhvilluar kriminaliteti.

Sipas nenit 3 të ligjit për polici të Republikës së Maqedonisë, funksioni themlor i policis është mbrojtja dhe rrespektimi i të drejtave dhe lirive themelore të qytetarit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet dhe marveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, mbrojtja e rendit juridik, parandalimi dhe zbulimi i veprave penale, ndërmarrja e masave për

⁸⁴ Po aty, fq.91

⁸⁵ Po aty, fq.108

⁸⁶ Po aty, fq.112

ndjekjen e kryerësve të atyre veprave, identifikimi dhe kërkimi direkt dhe në mënyrë të tërthortë të perfitimit pasurorë me kryerje të veprës penale, mbajtjen e rendit dhe qetësisë, rregullimin dhe kontrollin e trafikut rrugor, kontrollin për lëvizjen dhe qëndrimin e të huajve, kontrollime doganore dhe mbykëqyrje doganore, ofron ndihmë dhe mbrojtë qytetarëve në rast nevojë, siguron persona dhe objekte të caktuara dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.⁸⁷ Policia ka rëndësi të jashtëzakonshme në parandalimin e krimit, për shkak se kallzimet më të shpeshta bëhen në polici, dhe është organ i cili mund të reagojë më shpejtë se të gjitha organet tjera të drejtësisë. Gjithashtu për veprat penale për të cilat kryen në komunikacionin rrugorë është policia ajo që është më afër rrugës e kështu me radhë. Policia sipas funksioneve që u përmenden më lartë, ka një rol të jashtëzakonshëm në parandalimin e veprave penale në përgjithësi, gjithashtu edhe për veprat penale për të cilat shqiptohet dënimi me gjobë.

1.2.2.Prokuroria

Prokuroria është institucion klasik i judikaturës penale, i cili paraqitet qysh para 150 vjetësh, me qëllim që t'u kundervihet rreziqeve dhe veprimeve inkuizitore, që ka mbrojtur po në ato duar – në duart e gjykatësve – ndriçimin e veprave penale dhe gjykimin sipas tyre. Prej atëherë prokuroria zhvillohet në mënyrë specifike në disa vende ose grupe vendesh, varësisht nga kushtet e ndryshme të jetës dhe të zhvillimit. Në këtë vështrim dallojmë tipe të posaçme, siç është ai francez – italian, anglo – sakson, gjerman, sovjetik etj. Në sistemin anglo – sakson të prokurorisë është një histori e posaçme dhe, me një kuptim, dhe një funksion në raport me funksionin e prokurorisë në kontinuitetin e shteteve të tjera evropiane. Funksioni i prokurorisë në Angli e në SHBA ka të njëjtën traditë që daton nga sistemi anglez qysh nga koha e mesjetës, Porota e madhe angleze është themeluar më 1166, në kohën e Henrikut II, me detyrë që të hulumtojë dhe të akuzojë për vepra të rënda penale (Felonies). Më vonë, zhvillimi specifik historik i këtyre vendeve ka kushtëzuar një largim më të madh ndërmjet këtyre vendeve sa i perket organizimit dhe funksionimit të prokurorisë. Funksionimi i prokurorisë sot në Angli dhe SHBA dallohet shumë, ndonëse ka të njëjtën traditë. Krahas porotës së madhe të përbërë nga qytetarët për të akuzuar me rastin e veprave të rënda, në Angli ekziston tradicionalisht edhe akuzimi nga ana e funksionarit të posaçëm shtetëror, si dhe akuzimi nga ana e zyrtarit të kurorës. Më vonë shkaktohen dallime më të mëdha, kështu që sot kjo gjendje ka ndryshuar shumë. Përveç kësaj, me 1879 ka zënë të aplikohet edhe akuzimi nga ana e të ashtuquajturit “udhëheqës i ndjekjeve publike” për një perqindje shumë të vogël të veprave penale, i cili më së tepërmi i ngjan institucionit të prokurorit shtetëror në kontinent.⁸⁸

Në të drejtën e Republikës së Maqedonisë prokuroria publike është organ shtetërorë i unjisuar dhe i pavarur, i cili ndjek kryerësit e veprave penale dhe të veprave tjera ndëshkuese dhe kryen

⁸⁷ Neni 3 i ligjit për polici i Republikës së Maqedonisë

⁸⁸ Latifi, Vesel, POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë, 2011, fq.127

punë të tjera të parashikuara me ligj. Përveç funksionit të njëkjes së veprave penale në procedurë penale, në planin e gjërë të luftës kundër kriminalitetit, prokuroria publike ka të drejtë dhe detyrë, t'i përcjellë dhe t'i studiojë marrdhëniet dhe dukuritë shoqërore të rëndësishme për realizimin e funksionit të tyre, dhe për vrojtimit e veta, ta njoftojë kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të jep propozime për parandalimin e dukurive të rrezikshme dhe të dëmshme për shoqërinë si dhe për përforcimin e sundimit të ligjit. Prokuroria publike po ashtu ka të drejtë dhe për detyrë që ta infirmojë opinionin lidhur me gjendjen e kriminalitetit dhe për problemet dhe dukuritë e tjera me rëndësi të përgjithshme, të cilat i ka vërejtur në punën e vet. Informimi mund të bëhet edhe për rastet konkrete në të cilat vepron, por në kufijtë ligjor dhe në harmoni e interes të procedurës.⁸⁹ Nga kjo që u tha më lartë, tregon se prokuroria ka rol të rëndësishëm në parandalimin e kriminalitetit, poashtu edhe për veprat për të cilat parashihet dënim me gjobë. Pra prokurori vepron ashtu që për veprat të cilat shqiptohet dënimi me gjobë, merr persipër ndjekjen e veprave penale dhe me këtë rast ndikon në parandalimin e sjelljeve kriminale të kryerësve. Duke qenë palë me të akuzuarin, në praktikë gjithmonë prokurori kërkon që i akuzuari të dënohet në bazë të argumenteve që i ka mbledhur gjatë hetimit paraprak.

1.2.3. Gjykatat

Praktika e gjykatave është e ndërlidhur me legjislacionin penal dhe me qëndrimin e së drejtës penale. Kjo praktikë mbështetet në zgjidhjet ligjore në procesin e luftimit të kriminalitetit dhe të shqiptimit të sanksioneve penale. Kur gjykatësi e shqyrton një lëndë të caktuar, ai është i obliguar të zgjedhë në mesin shumë alternativave ato mundësi që i ofron norma penale, pra atë që më së tepërmi qëndron në funksionin e qëllimeve të politikës ndëshkimore. Kështu, individualizohet e ashtuquajtura "politike gjyqësore", e cila buron nga politika ligjdhënëse, duke u gërshetuar njëkohësisht edhe me qarqet dhe solucionet e saj. Ky kapërcim nga qëndrimi ligjor në praktikën ligjore, në individualizimin e përgjegjësisë dhe në konkretizimin e sanksioneve penale, do të thotë interpretim dhe zbatimim normative i disa rasteve të inkriminuara. Në këtë proces, duke iu përmbajtur rregullave dhe intencave normative, gjykatësi është i obliguar duke u nisur nga qëllimi i dënimit t'i marrë parasysh rrezikun shoqërorë të veprës penale dhe elementet relevante objektive dhe subjektive. Në kuadër të interpretimit të elementeve objektive, ai është i obliguar ta analizoje dhe vlerësojë rrezikun shoqërorë të sjelljeve të caktuara apo shkallën e rrezikimit ose të shkeljes së të mirës materiale që mbrohet dhe kështu ta përcaktojë politikën e dënimit ndaj këtij rreziku duke marrë parasysh edhe rrethanat e pranishme të situatës së caktuar. Gjykatësi po ashtu është i obliguar t'i respektojë gjatë këtij procesi elementet e domosdoshme dhe subjektive dhe, kështu gjykimin e vet ta harmonizojë me konceptin e risocializimit, si qëllim themelor i dënimit, të cilin e ka pranuar bota bashkëkohore, kështu që normat ligjore, në pajtim me këtë, duhet të lejojnë hapësirë të madhe për një aktivitet të tillë praktik. Pavarësia e gjykatës

⁸⁹ Sahiti, Ejup dhe Zejneli, Ismail; E DREJTA E PROCEDURËS PENALE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, Tetovë, 2007, fq.97

është një parim i njohur botërisht dhe i sanksionuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të 29.XI.1985. Në pikën 1 të kësaj Rezolute thuhet se pavarësia e drejtësisë garantohet nga shteti dhe përfshihet në kushtetutën ose në legjislacionin e vendit. Pavarësi e gjykatës nënkupton, në rradhë të parë, zgjidhjen e çështjes konkrete me paanësi dhe në perputhje me ligjin, pa u bërë objekt ndikim-esh, presionesh, kanosjesh ose ndërhyrjesh, drejtpërdrejta a të tërthorta nga kushdo e për çfarëdo.⁹⁰ Gjykatat themelore me kompetencë themelore për njësitë për të cilat janë themeluar, sipas nenit 30 të Ligjit mbi gjykatat, janë të autorizuar të vendosin në shkallë të parë për vepra penale dhe për kundërvajtje edhe atë : për vepra penale për të cilat me ligj si dënim kryesor është paraparë dënim me burg deri në pesë vjet, nëse për disa vepra penale nuk është e paraparë kompetenca e ndonjë gjykate tjetër, për veprat penale për të cilat me ligj të veçantë është paraparë kompetenca e gjykatës me kompetenca themelore, të realizojnë hetime dhe veprime hetimore për veprat penale nga kompetencat e veta.⁹¹ Sipas kësaj mund të konstatojmë se gjykatat janë organe të cilat kanë një rol të jashtëzakonshëm në parandalimin e veprave penale për të cilat shqiptohet dënim me gjobë, ngase me aktgjykimet e drejta që sjellë për veprat penale të shkaktuara me të cilat parashihet dënim me gjobë ndikon dukshëm në parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi. Pra, gjykata ka për detyrë që të jep vendime të drejta dhe të arsyeshme për shkak se gjithçka varet se në çfarë mase do të jetë dënimi i shqiptuar dhe si do të ndikojë ai lloj dënimi.

1.2.4. Institucionet penitenciare

Për ekzekutimin e dënimit të heqjes së lirisë dhe të sanksioneve tjera me karakter institucional në të gjitha sistemet ka institucione përkatëse, në të cilat zbatohen këto trajtime të posaçme dhe sëndërtohet risocializimi. Këto institucione mund të jenë të tipit të përgjithshëm, të përzier dhe të specializuar. Entet ndëshkimore – përmirësuese, përveç kategorizimit dhe ndarjes së tyre sipas kritereve të ndryshme si psh. Themeluesit, shkallës së sigurisë, llojit të personave të cilët e mbajnë dënimin në to, kanë edhe komponentët e vet të veçantë, e cila ka të bëjë me organizimin dhe strukturën e brendshme. Organizimi dhe struktura e brendshme ka ndikim të madh në realizimin e qëllimeve dhe të programit të tretmanit të personave të dënuar. Ekzistojnë ente të karakterit të përgjithshëm dhe të veçantë. Pastaj, entet sipas kriterit të moshës ndahen në ente ndëshkimore- përmirësuese për të mitur. Shikuar sipas gjinisë ka ente ndëshkimore-përmirësuese për meshkuj dhe ente ndëshkimore-përmirësuese për femra. Të gjitha këto lloje dhe klasifikime të enteve kanë domethënie e vet, mirëpo, për ta njohur rëndësinë dhe funksionimin e tyre, është e domosdoshme që të njihet organizimi dhe struktura e brendshme e këtyre enteve.⁹²

Në Republikën e Maqedonise ekzistojnë këto lloje të institucioneve: institucionet ndëshkimore – korrektuese dhe institucionet edukuese – korrektuese. Institucionet ndëshkimore – korrektuese

⁹⁰ Latifi, Vesel, POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë, 2011, fq.131,132

⁹¹ Neni 30 I Ligjit mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë

⁹² Latifi, Vesel, POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë, 2011, fq.136

mund të jenë: shtëpi ndëshkimore – korrektuese dhe burgje. Institucionet ndëshkuese – korrektuese janë: Shtëpi ndëshkimore – korrektuese Idrizovë me repart të hapur në Veles, Shtëpia ndëshkimore – korrektuese Shtip, Shtëpia ndëshkuese – korrektuese e llojit të hapur në Strugë, Burgu i Manastirit, Burgu i Gjevgjeli, Burgu i Kumanovës me Repart të hapur në Kriva Pallankë, Burgu i Ohrit, Burgu i Prilepit, Burgu i Shkupit, Burgu i Strumicës dhe Burgu i Tetovës. Institucione edukuese – korrektuese janë: Shtëpia edukuese – korrektuese Tetovë dhe Shtëpia edukuese – korrektuese Shkup.⁹³ Burgjet janë institucione të themeluara tek të cilat zakonisht bëhet ekzekutimi i dënimit me burgim, me kohëzgjatje të shkurtër. Nëpër burgje ekzekutohen dënime me burgim në afat të shkurtër. Zakonisht, personat e dënuar në burgje qëndrojnë deri në 3 muaj. Mirëpo, në disa shtete, për shkak të mungesës së institucioneve adekuate, shpeshherë në burgje qëndrojnë edhe personat e dënuar me burgim, që janë dënuar me dënime më të gjata.⁹⁴ Institucionet ndëshkimore – korrektuese dallohen për kah shkalla e sigurisë, edhe ekzistojnë tre tipa të këtyre institucioneve: të tipit të mbyllur, gjysëm të hapur dhe të hapur. Varësisht nga tipi i institucionit, dallon edhe shkalla e sigurisë, edhe atë, në tipin e mbyllur hasim muret me rrethojë, mjetet teknike dhe masa të tjera për sigurim me të cilat pengohet arratisja e personave të dënuar; në tipin gjysëm të hapur sigurimi është më pak i rreptë, më liberal, por sërish personat e dënuar janë të kufizuar në shumë të drejta dhe liri të tyre; institucionet e llojit të hapur nuk kanë sigurim fizik dhe material.⁹⁵ Në të gjitha këto institucione në të cilat zbatohen dënimet e heqjes së lirisë dhe sanksione të tjera me karakter institucional, shërbejnë për zbatimin e trajtimeve përkatëse dhe për arritjen e risocializimit, si qëllim themelor i dënimit dhe i ekzekutimit të këtyre sanksioneve. Ky qëllim arrihet po që se në këto institucione, nëpërmjet zbatimit të trajtimeve, masave dhe regjimeve pedagogjike, psikologjike, punonjësve e të tjera, bëhen aso ndryshimesh në personalitetin e të dënuarit, sa ai të aftësohet për t'u inkadruar në jetën në liri, sipas shprehive të krijuara për punë, ndjenjave të krijuara të përgjegjësisë dhe të respektimit të vlerave shoqërore.⁹⁶ Nga kjo që u tha më lartë, del se po që se realizohen në mënyrë të drejtë këto masa dhe trajtime ndaj të dënuarve, institucionet penitenciare kanë potencialin që të ndikojnë në parandalimin e veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë, pasi që masat dhe trajtimi i tillë e bëjnë personin e dënuar që të kthehet në shoqëri si person i vlefshëm dhe të kontribuojë që në të ardhmen të mos kryhen vepra penale të asaj natyre. Mund të konstatojmë se për të parandaluar veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë, janë të angazhuara një masë e madhe institucionesh shtetërore poashtu edhe organizata të ndryshme që janë në shërbim të parandalimit të krimit. Edhe pse puna e këtyre institucioneve është e madhe, përsëri mendoj se ka shumë gjëra që mund të shtojnë masat e parandalimit, si me ndërhyrjen e ligjeve të caktuara, duke bërë ndryshimin e ligjeve dhe duke i harmonizuar ato me ligjet evropiane, poashtu edhe me programe dhe aktivitete të ndryshme të organizatave joqeveritare, duke ndikuar pozitivisht tek kryerësit e veprave penale për të cilat

⁹³ Osmani, Afrim; PENOLOGJIA, Shkup, 2017, fq.215

⁹⁴ Po aty, fq 215

⁹⁵ Po aty, fq.217

⁹⁶ Latifi, Vesel, POLITIKA KRIMINALE, Prishtinë, 2011, fq.139

parashihet dënim me gjobë, që në të ardhmen të mos kryejne vepra të ngjashme. Pa marrë parasysh se çfarë shkalle të sigurise janë këto institucione, një gjë është e qartë se kushtet në këto institucione në Republikën e Maqedonisë nuk janë të përshtatshme, duke u nisur nga ushqimi apo higjiena, pra nuk trajtohen të burgosurit ashtu siç parashihet me ligj dhe me konventat ndërkombetare. Këtë mendim e kam nga vizita studimore që kam realizuar gjatë studimeve në disa nga këto institucione të lartëpërmendura. Nëse këto kushtet nuk u ofrohen të dënuarve atëherë është shumë e vështirë që të arrihet qëllimi i dënimit nëpër këto institucione, nga shkak se nga mungesat elementare nuk mund të përfshihen në procesin e risocializimit.

Perfundimi

Dënimi me gjobë si temë, është punim me të cilin jam munduar që të spjegoj në atë mënyrë që të jetë në interes të qytetarëve, duke e ditur se çka paraqet ky dënim, si shqiptohet, për cilat vepra shqiptohet dhe sa është lartësia e dënimit, të dinë numrin e dënimeve që shqiptohen gjatë një viti apo disa viteve me radhë, duke krahasuar numrin e dënimeve nga viti në vit, duke ofruar të dhëna statistikore nga burime të ndryshme, kryesisht nga burimet e Gjykatës Themelore të Tetovës, poashtu edhe nga Enti Shtetërorë për statistikë.

Nga të dhënat statistikore del se numri më i madh i dënimeve me gjobë si dënim kryesor, janë veprat penale kundër sigurisë në komunikacion si dhe për veprat penale kundër pasurisë. Poashtu në këtë punim të magjistraturës kam paraqitur të dhëna në mënyrë tabelare për aksidentet që ndodhin nga shkak i veprave penale të shkaktuara në komunikacion si dhe për dënimet që janë shqiptuar për veprën penale të vjedhjes, ku shihet një dominim i veprave penale të shkaktuara në komunikacion.

Procedura e shqiptimit dhe ekzekutimit të dënimit me gjobë si dënim kryesor. Çmoj se është në interes të veçantë për qytetarët ngase aty spjegohet mënyra e pagesës së dënimit, kushtet që duhet të plotësohen si dhe lehtësimet e pagesës, siç janë afatet e dhëna, mundësia e pagesës me kështu por edhe lirimi nga dënimi në raste të caktuara.

Në këtë punim, fillimisht spjegohet rrjedha historike e dënimit nëpër periudha të ndryshme, pastaj për sistemin e gjobës ditore, qëllimi i dënimit me gjobë, domethënë çka është esenca e këtij dënimi. Gjithashtu në këtë punim ka paraqitur edhe si bëhet zbatimi në Kodin penal të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, për të parë ngjashmëritë dhe dallimet në krahasim me sistemin tonë të dënimit me gjobë.

Gjithashtu në këtë punim kam spjeguar edhe për dënimin me gjobë si dënim kryesor për personat fizik dhe juridik, pra kam spjeguar se si bëhet shqiptimi dhe ekzekutimi i dënimit me gjobë, të cilat procedura dallojnë për personat fizik dhe për personat juridik.

Kam trajtuar çështjen e fenomenologjisë dhe etiologjisë në mënyrë më të detajuar duke ofruar të dhëna statistikore për secilën, pra për fenomenet që paraqiten kur shqiptohet dënimi me gjobë si dhe për faktorët kriminogjen që ndikojnë në kryerjen e veprave penale kur shqiptohet dënimi me gjobë. Dhe në kapitullin e fundit kam spjeguar për rolin parandalues të shumë institucioneve shtetërore në kryerjen e veprave penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë. Gjatë hulumtimit kam vërejtur së dënimi me gjobë është dënim i cili shqiptohet më së shumti për kategoritë e personave me ekonomi të dobët. Kjo nuk është e habitshme nga shkak se vendi jonë është vend me ekonomi të dobët, vend ku jetojnë njerëz me të ardhura shumë të ulëta, të cilët nuk mund të plotësojnë nevojat elementare.

Të dhënat statistikore që i kam paraqitur si dhe shpjegimet që i kam dhënë në përgjithësi gjatë këtij punimi, shpresoj që të jenë në dobi të qytetarëve, të kenë një pasqyrë reale për këtë lloj dënimi dhe shpresoj që numri i këtyre veprave penale në të ardhmen të jetë sa më i vogël.

Gjatë punimit kam dhënë vërejtjet dhe rekomandimet e mia. Poashtu me këtë punim u bëj apel organeve shtetërore që të zhvillojnë dhe të investojnë më shumë në çështjen e parandalimit të veprave penale, marrë masa të ndryshme të përshtatshme , pasi që vetëm në këtë mënyrë mund të reduktohet numri i aktiviteteve kriminale dhe jam i bindur se me angazhim më të madh të institucioneve numri i aktiviteteve kriminale do të jetë shumë më i ulët.

Literatura

Halili, Dr. Ragip

“Kriminologjia”, Prishtinë, 2008

“Penologjia- Shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale”, Prishtinë, 2005

Kambovski, Dr. Vllado;

“E drejta penale- pjesa e përgjithëshme” (përkthim) përkthyen: Ismail Zejneli, Afrim Osmani; SHB “Furkan ISM” Shkup, 2006

Крстаноски, Миладин;

“Криминалитет и детекција” Охрид, 2010

Latifi, Dr.Vesel;

“Kriminalistika- Zbulimi dhe të provuarit e krimit“ Botimi i gjashtë; Prishtinë, 2009

“Politika Kriminale, Prishtinë, 2011

Марјановиќ, Ѓорѓи;

“Македонско право-општ дел”, Скопје, 1998

Osmani, Afrim ;

“Penologjia“, Shkup, 2017

“Kodi penal i Republikës së Maqedonisë”- teksti integral i përpunuar në gjuhën shqipe, Shkup, 2010.

Salihu, Dr.Ismet;

“E drejta penale pjesa e përgjithshme”, Prishtinë, 2008

Sërzeniq Nikolla- Stajiq Aleksandër;

“E drejta penale”, Prishtinë, 1972

Sulejmanov, Zoran;

“Makedonska Kriminologija”, Skopje, 2000

Сламков, Ѓорѓи;

“ Казнено право-општ дел”, Skopje, 2009

Ukaj, Dr. Bajram;

“Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë”, Prishtinë, 2006

Zejneli, Dr. Ismail:

“E Drejta penale- pjesa e posaçme”, Tetovë, 2007

Zimeri, Jusuf:

“E drejta penale islame”- dispencë; Shkup,

**“ ЗБОРНИК НА ТРУДОВИ НА ПРАВНИОТ ФАКУЛТЕТ „ ЈУСТИНИАН ПРВИ”
ВО СКОПЈЕ, ПОСВЕТЕН НА ШРОФ.Д-Р ФРАЊО БАЧИЌ, Скопје, 2007**

Kode dhe ligje

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Shkup, Nr.08-462/1, me ndryshime dhe plotësime të vitit 2009,

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 1996, me ndryshime dhe plotësime të vitit 2006 (‘‘Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë’’, Nr. 62/06),

Ligji mbi Prokurorinë publike i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2003 (‘‘Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë’’, Nr.2/06),

Ligji mbi gjykatat i Republikës së Maqedonisë, Shkup 2006 (‘‘Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë’’, Nr.58.06),

Ligji i procedurës penale i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2005 (‘‘Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë’’, Nr.15/05),

Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2006 (‘‘Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë’’, Nr.2/06),

Kodi penal i Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082 20 prill 2012

Kodi penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.27.1.1995

Ligji mbi Policinë i Republikës së Maqedonisë (teksti i përpunuar), Shkup, 2015 (‘‘Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.114/06).

Ligji për shoqata dhe fondacione i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2010 (‘‘Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.52)

Të dhëna nga Enti Shtetërorë për statistikë

Të dhëna nga Gjykata Themelore e Tetovës

Vendime nga Gjykata Themelore e Tetovës

Shfrytëzimi i internetit:

www.malc.mk

www.stat.gov.mk- Të dhëna statistikore

https://sq.wikipedia.org/wiki/Organizata_jogeveritare

<http://www.mvr.gov.mk> Publikime nga Ministria për punë të brendshme

www.pravo.org.mk

Table of contents

- **Subject of research**
- **The purpose of research**
- **Metodology of research**

Introduction part

CHAPTER ONE

<i>I. System of punishments</i>	<i>9</i>
1.1. History.....	10
1.2. Meaning of fine penalty in Penal code of Republic of Macedonia.....	12
1.3. Purpose of fine penalty.....	13
1.4. Applicability of fine penalty in some penal codes of region.....	14

CHAPTER TWO

<i>I. Measurement of fine penalty according to penal code of Republic of Macedonia.....</i>	<i>17</i>
1. 1 legal measurement according to penal code of Republic of Macedonia	17
1.2. judicial measurement according to penal code of Republic of Macedonia	18
1.3. Enunciation and execution of fine penalty.....	20
1.4. Determination of daily value of fine penalty.....	23

CHAPTER THREE

I. Fine penalty as major penalty for physical persons and legal persons..... 25

1.1. Fine penalty as major penalty for physical persons..... 25

1.2. Fine penalty as major penalty for legal persons..... 26

1.3. Execution or substitution of fine penalty with prison..... 30

CHAPTER FOUR

I. Criminal aspects of fine penalty..... 32

1.1. Fenomenology of enunciation of fine penalty in the territory of basic court of Tetovo from year 2007 – 2012..... 32

1.1.1. criminal offenses against traffic safety.....33

1.1.2. criminal offenses against property.....35

1.2. Etiology of criminal offenses when fine penalty is enunciated..... 39

1.2.1. Objective factors.....39

1.2.2. Subjektive factors.....42

1.3. Execution of fine penalty in the territory of basic court of Tetovo from year 2007-2012.....44

CHAPTER FIVE

<i>I. Prevention and fighting the criminal offenses when fine penalty is enunciated.....</i>	<i>48</i>
1.1. Preventive measures.....	48
1.1.1. Schooling and education	49
1.1.2. Role of written and electronic media.....	50
1.1.3 Nongovernmental organizations.....	51
1.1.4. Role of famiy.....	52
1.2. Repressive measures.....	52
1. 2.1 Policy.....	53
1.2.2 Prosecutor.....	54
1.2.3 Courts.....	55
1.2.4 Penitentiary institutions.....	56
Conclusion.....	59
References.....	61
Table of contents.....	65